

Marrëveshje për Mbështetje të Sponsorit¹

ndërmjet

Republikës së Kosovës
që vepron përmes **Ministrit të Zhvillimit Ekonomik**

dhe

ContourGlobal Terra 6 S.à r.l.
si Sponsorizues HoldCo

dhe

ContourGlobal Terra 6 S.à r.l.
si GenCo

John J. Beardsworth, Jr.
951 E. Byrd St.
Richmond, VA 23219
Telefoni: +1 804 788 8637
jbeardsworth@hunton.com

¹ Kjo marrëveshje është përkthyer në shqip nga origjinali në Anglisht

PASQYRA E PËRMBAJTJES

Article 1	Përkufizimet; Interpretimi	1
1.1	Përkufizimet	1
1.2	Interpretimi.....	5
Article 2	Data e hyrjes në fuqi; afati	7
2.1	Data e hyrjes në fuqi; afati	7
Article 3	Pagesa e kapitalit.....	7
3.1	Kontributi	7
3.2	Njoftimi i QK.....	7
3.3	Certifikimi i kontributit	7
Article 4	Kufizimet në transferimin e interesave të pronësisë.....	8
4.1	Kufizimet në transferimin e interesave të pronësisë së Sponsorit.....	8
Article 5	Siguria e financimit	9
5.1	Siguria e financimit	9
5.2	Obligimet e Sponsor HoldCo	10
5.3	Zëvendësimi dhe anulimi i sigurimit	10
Article 6	Fondi për zhvillimin e komunitetit	11
6.1	Fondi për zhvillimin e komunitetit	11
Article 7	Dështimi.....	11
7.1	Ngjarjet e dështimit të Sponsor HoldCo.....	11
Article 8	Zotimet dhe garancitë.....	12
8.1	Zotimet dhe garancitë e GenCo-s	12
8.2	Zotimet dhe garancitë e Sponsor HoldCo.....	13
8.3	Zotimet dhe garancitë e QK	14
8.4	Riafirmimi i zotimeve dhe garancive	14
Article 9	Kufizimi i përgjegjësisë	14
9.1	Kufizimi i përgjegjësisë	14
Article 10	Garancia e sponsorit përfundimtar	15
10.1	Garancia e sponsorit përfundimtar	15
Article 11	Të ndryshme.....	15
11.1	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve.....	15
11.2	Njoftimet	15
11.3	Ndryshimet.....	16
11.4	Bashkëpunimi, ndihma dhe informimi nga QK.....	16
11.5	Mbijetesa.....	17
11.6	Palët e Treta Përfituese.....	17
11.7	Nuk ka Heqje Dorë.....	17
11.8	Marrëdhënia mes Palëve	17

11.9	Shpenzimet e Palëve	17
11.10	Pëlqimi	18
11.11	Gjuha.....	18
11.12	Ligji Qeverisë	18
11.13	Tërësia.....	18
11.14	Caktimi.....	18
11.15	Konfidencialiteti.....	18
11.16	Mjetet juridike lehtësuese.....	19
11.17	Nuk ka përgjegjësi për shqyrtim	19
11.18	Palët homole.....	20
11.19	Sigurimet e mëtutjeshme	20
11.20	Pandashmëria	20
11.21	Pavlefshmëria e Pjesshme	20
Schedule 1		
	Forma e financimit Letër kredie	1
Schedule 2		
	Formulari i garancisë së sponsorit përfundimtar	2

KJO MARRËVESHJE PËR MBËSHTETJE TË SPONSORIT (“Marrëveshja”) lidhet më 19 shkurt 2018 (“**Data e ekzekutimit**”) ndërmjet:

- (1) ContourGlobal Terra 6 S.à r.l. (“**Sponsor HoldCo**”), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (*société à responsabilité limitée*) organizuar sipas ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut, me zyrë të regjistruar në adresën 35-37 Avenue de la Liberté, L-1931 Luksemburg, Dukati i Madh të Luksemburgut dhe regjistruar në Regjistrin e Tregtisë dhe Kompanive në Luksemburg me numër B 195.738;
- (2) ContourGlobal Terra 6 S.à r.l. (“**GenCo**”), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (*société à responsabilité limitée*) organizuar sipas ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut, me zyrë të regjistruar në adresën 35-37 Avenue de la Liberté, L-1931 Luksemburg, Dukati i Madh të Luksemburgut dhe regjistruar në Regjistrin e Tregtisë dhe Kompanive në Luksemburg me numër B 195.738, në cilësinë e tij si GenCo; dhe
- (3) Republika e Kosovës (“**QK**”) duke vepruar përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik me zyrën e saj kryesore në rr. Nënë Tereza nr. 36 Prishtinë, Kosovë.

Të trija, Sponsor HoldCo, GenCo, dhe QK, në tekstin e mëtejme referohen individualisht si “**Pala**” dhe, bashkërisht, “**Palët**.”

PËRSHKRIMET (RECITALET)

- A. QK ka për qëllim të përfshijë sektorin privat në një projekt të infrastrukturës që përfshin zhvillimin, projektimin, ndërtimin, financimin, pronësinë, operimin dhe mirëmbajtjen e objektit të TCKR (të përkufizuar më poshtë) dhe rehabilitimin e Lokacionit (siç përcaktohet më poshtë) nga GenCO (“**Projekti Kosova e Re**”);
- B. GenCo ka për qëllim të formojë një subjekt të ri të organizuar sipas ligjeve të Kosovës (“**CG Kosovë**”), dhe pas formimit të CG Kosovë, GenCo synon t’i bart të gjitha të drejtat, titullin dhe interesin e tij dhe t’i delegojë obligimet e tij nën këtë Marrëveshje tek CG Kosovë dhe QK pranon dhe pajtohet me këtë bartje;
- C. QK ka lidhur Marrëveshjen e Zbatimit me GenCo për të lehtësuar zbatimin e Projektit Kosova e Re; dhe
- D. Është kusht i Marrëveshjes së Zbatimit që Sponzori HoldCo të lidh këtë Marrëveshje me QK dhe GenCo.

PRANDAJ, duke pasur parasysh premtimet dhe pajtimet e ndërsjella të përfshira në këtë dokument, dhe me qëllim që të jenë ligjërish të detyrueshme, Palët bien dakord si më poshtë:

Article 1 Përkufizimet; Interpretimi

1.1 Përkufizimet

Sa herë që të paraqiten shprehjet vijuese me shkronjë të parë të madhe në këtë Marrëveshje, në Listat, ose Shtojcat, ato do të kenë kuptimet si në vijim:

“Palë e ndërlidhur” - Çdo person, çdo personi tjetër që, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nëpërmjet një ose më shumë ndërmjetësve, kontrollon, kontrollohet ose është nën kontroll të përbashkët me Personin e tillë; me kusht që “Personi i ndërlidhur” në asnjë rast (përveç në lidhje me detyrimin e konfidencialitetit dhe zbulimin e lejueshëm të përcaktuar në Nenin 11.15(c)(i)) nuk përfshin ndonjë Person që ka interes kapital të drejtpërdrejt ose tërthorë në Sponsorin Përfundimtar. Për qëllime të këtij përkufizimi, “kontrolli” (përfshirë, me kuptime korrelative, termat “në kontroll”, “nën kontroll të përbashkët me” dhe “kontrolluar nga”), siç përdoret në lidhje me çdo person, nënkupton posedimin, të drejtpërdrejt ose tërthorë, të

autoritetit për të drejtuar ose shkaktuar drejtimin e menaxhmentit ose politikave të Personit të tillë, qoftë përmes pronësisë së aksioneve me të drejtë të votimit ose interesave të tjerë të kapitalit, me kontratë ose ndryshe. Për qëllime të këtij përkufizimi, secila NP do të jetë “Palë e ndërlidhur” e QK.

“Marrëveshje” - Ka kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës.

“Ditë pune” - Çdo Ditë përveç të shtunës, të dielës, apo Ditëve në të cilën bankat komerciale në Prishtinë, Kosovë, janë të lejuara me ligj që të jenë të mbyllura për punë.

“Data e blerjes” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Zbatimit.

“CG Kosovë” - Ka kuptimin e cekur në recitale.

“Dokumentet themeltare” - Për sa i përket një subjekti të posaçëm:

- (a) të gjitha dokumentet e organizimit dhe qeverisjes, përfshirë të gjitha dokumentet e miratuara ose të paraqitura në lidhje me krijimin, formimin ose organizimin e një subjekti të tillë;
- (b) të gjitha marrëveshjet e aksionarëve, marrëveshjet e votimit, marrëveshjet e besimit të votimit, marrëveshjet e kompanisë, marrëveshjet e operimit, marrëveshjet e partneriteteve, marrëveshjet për të drejtat e regjistrimit, apo marrëveshjet e ngjashme; dhe
- (c) të gjitha ndryshimet e plotësimet e tyre.

“Data e operimit komercial” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë.

“Fondi për zhvillimin e komunitetit” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Zbatimit.

“Kontratat e ndërtimit/mirëmbajtjes” - Kontrata EPC, Marrëveshja LTM, Kontrata e O&M, Kontrata EPC e punëve të kyçjes së GenCo, Kontrata e specifikuar e Rehabilitimit të Gjendjes Mjedisore (të përcaktuar në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë), dhe Marrëveshjen për Shërbime Administrative (të përcaktuar në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë), bashkërisht.

“Kontraktuesit” - Kontraktuesit e drejtpërdrejtë të cilësdo Palë dhe nëkontraktuesit e tyre të drejtpërdrejtë, në secilin rast, të cilët janë të përfshirë në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Kontratën e Ndërtimit/Mirëmbajtjes apo çfarëdo aktiviteti që ka të bëjë me Projektin Kosova e Re.

“Dita” - Një periudhë prej njëzetekatër (24) orësh, duke filluar në orën 00:00 të secilës ditë dhe shprehja “Ditore” do të interpretohet në përputhje me rrethanat.

“Rastet që konsiderohen Përmbyllje nga ana e GenCo” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Blerjes së Lokacionit.

“Kontest” - Çdo kontest, mosmarrëveshje, kundërthënie ose dallim mes Palëve që rrjedh nga Marrëveshja, ose në lidhje me të, duke përfshirë çdo kontest, mosmarrëveshje, kundërthënie ose dallim në lidhje me ekzistencën, ligjshmërinë, vlefshmërinë ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, apo ndonjë dispozite të kësaj Marrëveshjeje, ose zbatimin apo shkeljen e një Pale të ndonjë dispozite të kësaj Marrëveshjeje dhe gjithashtu duke përfshirë çdo kontest, mosmarrëveshje, kundërthënie ose dallim ndërmjet Palëve, në NP-je të Specifikuar ose Sponsorin Përfundimtar në lidhje me detyrimet jokontraktuese që rrjedhin në kuadër të kësaj marrëveshjeje, jashtë saj, ose në lidhje me të.

“Data e hyrjes në fuqi” - Ka kuptimin e cekur në Nenin 2.1(a).

“Kontrata EPC” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë.

“ZRRE” - Zyra Rregullative e Energjisë dhe çdo agjenci tjetër pasuese apo zëvendësuese rregullative me autoritet dhe jurisdiksion mbi sektorin e energjisë në Kosovë.

“Euro” apo “€” – Valuta e vetme e shteteve anëtare pjesëmarrëse të Bashkimit Evropian.

“Data e ekzekutimit” - Ka kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës.

“Depoziti financiar” - Ka kuptimin e cekur në nenin 5.1.

“Dokumentet financuese” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Zbatimit.

“Letërkredia financuese” - Ka kuptimin e cekur në nenin 5.1.

“Sigurimi financues” - Ka kuptimin e cekur në nenin 5.1.

“Rasti i tërheqjes së sigurimit financues” - Rastet e identifikuar si Raste të Tërheqjes së Sigurimit Financues në nenin 5.1.

“GenCo” - Ka kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës.

“Kontrata EPC për punimet e lidhjes së GenCo” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë.

“QK” - Ka kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës.

“Kodi i Rrjetit” - Kodi i rrjetit i përgatitur nga KOSTT dhe i aprovuar nga ZRRE në fuqi në datën e ekzekutimit, në dispozicion në http://www.kostt.com/website/index.php?option=com_content&view=article&id=543&Itemid=481&lang=en.

“Obligimi i garantuar” - Ka kuptimin e cekur në nenin 1.1 të Listës 2.

“Marrëveshja e Zbatimit” - Marrëveshja me po këtë emër ndërmjet GenCo dhe QK me datë në apo afër datës së ekzekutimit e që ka të bëjë me Projektin Kosova e Re.

“KEK Prodhimi” – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a., shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Kosovës, më zyrë kryesore në rr. Nëna Terezë nr. 36, Prishtinë, Kosovë, dhe me numër të regjistrimit të biznesit nr. 70325399, që operon përmes njësisë së saj të biznesit që është përgjegjës për kapacitetin e prodhimit.

“KEK Mihja” – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a., shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Kosovës, më zyrë kryesore në rr. Nëna Terezë nr. 36, Prishtinë, Kosovë, dhe me numër të regjistrimit të biznesit nr. 70325399, që operon përmes njësisë së saj të biznesit që është përgjegjës për kapacitetin e mihjes.

“KESCO” – Kompania e Furnizimit të Energjisë Elektrike të Kosovës sh.a., shoqëri aksionare e organizuar në kuadër të ligjeve të Kosovës, me zyrë kryesore në Bulevardin Bill Clinton nr. 3, Prishtinë, Kosovë, dhe me numër të regjistrimit të biznesit nr. 70606119.

“Kosovë” – Republika e Kosovës.

“Projekti Kosova e Re” - Ka kuptimin e cekur më lartë.

“KOSTT” – “OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU – KOSTT” SH.A., shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Kosovës, me zyrë kryesore në rr. Isa Boletini nr. 39, 1000 Prishtinë, Kosovë, dhe me numër të regjistrimit të biznesit nr. 70325350, apo pasardhësit në rast se KOSTT ndërpret funksionin e TSMO në kuadër të Kodit të Rrjetit.

“Struktura e TCKR” - Objekti i termocentralit të prodhimit të energjisë me djegie të linjitet që do të vendoset në Obiliq, Kosovë, siç përshkruhet më në hollësi në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë Elektrike.

“Ligjet e Kosovës” - Ligjet e Kosovës, si dhe të gjitha statutet, traktatet, kodet, urdhëresat, urdhrat, rregullat, rregulloret, urdhrat ekzekutivë, vendimet gjyqësore, njoftimet, vendimet, rregulloret dhe aktet nënligjore apo direktivat e tjera të ngjashme të lëshuara nga cilido Autoritet Publik, në çdo rast, që është janë të aplikueshme për Palët, Projektin Kosova e Re, ose në lidhje me Marrëveshjen e Projektit, një

Dokument Financiar ose një Kontrate Ndërtimi/Mirëmbajtje, përfshirë ndryshimet e plotësimet, zëvendësimet, riinterpretimet apo modifiket e tyre nga Autoritetet Publike të Kosovës, herë pas here.

“Kredidhënës” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Zbatimit.

“Marrëveshja LTM” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë.

“Memorandum Mirëkuptimi ” - Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet QK dhe ContourGlobal LP, ortakëri me përgjegjësi të kufizuara e organizuar sipas ligjeve të Ishujve Kajman, të datës 18 dhjetor 2015.

“Ministria e Zhvillimit Ekonomik” - Ministria e Zhvillimit Ekonomik e QK ose, në rast se emri ose përgjegjësia e kësaj ministrie ndryshohet, ministria ose ministrinë e QK ngarkohen me përgjegjësinë për minierat dhe energjinë elektrike.

“NKEC” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë.

“Kontrata O&M” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë.

“Interesi i pronësisë” - Në lidhje me çdo korporatë, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ortakëri ose organizatë tjetër afariste, aksionet, interesat e pronësisë ose interesa të tjera të ngjashme në një organizatë të tillë biznesi me (i) të drejta votimi apo të tjera të menaxhimit dhe kontrollit, apo (ii) pjesëmarrje kapitali në to dhe letrat me vlerë të organizatës së tillë afariste që janë të konvertueshme në të njëjtën me opsionin e mbajtësit.

“Pala” dhe “Palët” - Kanë kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës.

“Kontest i pagesës” - Kontest që lidhet me ndonjë detyrim të pagesës aktuale ose të kushtëzuar (përveç atyre që lindin drejtpërdrejt nga ndërprerja e kësaj Marrëveshjeje) që mund të lindin ndërmjet Palëve lidhur me këtë Marrëveshje, që në çdo rast është lloji i çështjes që është në masë të arsyeshme i nënshtrohet shqyrtimit dhe zgjidhjes nga një ekspert me përvojë përkatëse.

“Barrët e lejuara (GenCo)” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Zbatimit.

“Personi” - Çdo individ, korporatë, ortakëri, sipërmarrje e përbashkët, shoqatë, trust biznesi, organizatë e pakorporatizuar, autoritet publik, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose subjekt tjetër.

“Marrëveshja për blerjen e energjisë” – Marrëveshja me këtë emër ndërmjet NKEC dhe GenCo me datë në ose afër datës së ekzekutimit.

“Marrëveshjet e projektiti” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Zbatimit.

“Autoriteti Publik” - Të gjitha në vijim me juridiksion mbi GenCo, Projektin Kosova e Re, ose ndonjë pjesë të tij:

- (a) QK, çdo nëndivizion i saj, apo çdo autoritet i pushtetit lokal;
- (b) çdo departament, autoritet, instrument, agjenci ose organ gjyqësor i ndonjë Autoriteti Publik të përshkruar në paragrafin (a) më lart;
- (c) gjykatat dhe tribunalet në Kosovë;
- (d) të gjitha agjencitë e pavarura rregullative që kanë juridiksion mbi GenCo, Projektin Kosova e Re, ose ndonjë pjesë të tij; ose
- (e) çdo autoritet shtetëror, i qytetit, krahinës, komunës, nivelit lokal apo rajonal, departament, organ, byro, instrument, komision, korporatë, degë, drejtori, agjenci, ministri, gjykatë, tribunal, autoritet gjyqësor, organ legjislativ, organ administrativ, organ rregullativ, subjekt autonom apo kuazi-autonom ose autoritet tatimor ose ndonjë departament, komunë ose nëndivizion tjetër politik, duke përfshirë, mes tjerash, çdo Person (qoftë autonom apo jo) që ushtron funksione ekzekutive,

legjislative, gjyqësore, rregullative ose administrative ose që kanë të bëjnë me ndonjërin prej subjekteve të lartpërmendura.

“Ndërmarrje Publike” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë.

“Bankë e Kualifikuar” - Një bankë komerciale detyrimet afatgjata seniore të borxhit të pasiguar të së cilës, të shprehura në euro, ka rejting A apo më të lartë nga S&P ose ekuivalent nga një institucion tjetër i madh i mirënjohur ndërkombëtar për klasifikim të kredive dhe, gjatë lëshimit të Letrës së Financimit të Kredisë, (i) në diskrecion të vetëm të QK, nuk do të ishte i kundërt me interesat e sigurisë kombëtare të Kosovës dhe (ii) nuk është i përfshirë në asnjë proces gjyqësor me QK ose ndonjë Autoritet Publik.

“Ngjarje e tërheqjes për dështim të zëvendësimit” - Çdo ngjarje, gjendje, apo rrethanë e identifikuar në nenin 5.3 që i jep të drejtë Qeverisë së Kosovës që të tërheq Sigurimin e Financimit.

“Kredia e aksionarit” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë.

“Lokacioni” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë.

“Marrëveshja për transferimin e lokacionit” Marrëveshja me këtë emër ndërmjet KEK Prodhimit dhe GenCo me datë në ose afër datës së ekzekutimit.

“NP e specifikuar” dhe “NP të specifikuara” – Të gjitha minierat e KEK-ut, KEK Prodhimit, NKEC, KOSTT, Furnizuesi i Ujit dhe çdo Ndërmarrje tjetër Publike që është palë në Marrëveshjen e Projektit, sipas kontekstit. Pavarësisht të gjithave që dëshmojnë të kundërtën, çdo Person që nuk është Ndërmarrje Publike, që është pasardhës i interesave të një NP të Specifikuar sipas Marrëveshjes së Projektit, do të konsiderohet si NP e Specifikuar.

“Sponsor HoldCo” - Ka kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës.

“Ngjarje e dështimit të Sponsor HoldCo” – Ka kuptimin e cekur në nenin 7.1.

“Pala e Sponsor HoldCo” - Një aksionar, drejtor, zyrtar, punonjës, përfaqësues, agjent, anëtar, menaxher ose i afërm i Sponsor HoldCo, duke përfshirë Sponsorin e Fundit dhe GenCo.

“Tatimet” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë.

“Kontest teknik” - Kontest që ka të bëjë me një çështje teknike, inxhinierike, operacionale, kontabël ose çështje që lidhet me këtë Marrëveshje, që në çdo rast është lloji i çështjes ose çështjes që në mënyrë të arsyeshme i nënshtrohet shqyrtimit dhe zgjidhjes nga një ekspert në fushën ose fushat përkatëse.

“Afati” - Ka kuptimin e cekur në nenin 2.1.

“Data e transferimit” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Transferimit të Lokacionit.

“OSTT” - Operatori i sistemit, pronari i rrjetit të transmisionit dhe operatori i tregut, siç përcaktohet në Kodin e Rrjetit.

“Sponsori fundor” - ContourGlobal plc, një kompani publike me përgjegjësi të kufizuar e korporatizuar në Angli dhe Uells, me zyra të regjistruara në 15 Berkeley Street, 6th Floor, London W1J 8DY, Engalnd.

“Furnizuesi i ujit” – HPE Ibër-Lepenc sh.a. shoqëri aksionare e organizuar në kuadër të ligjeve të Kosovës, me zyrë kryesore në Bulevardin Bill Clinton nr. 13, Prishtinë, Kosovë, dhe me numër të regjistrimit të biznesit nr. 70465157.

“Banka Botërore” dhe “Grupi i Bankës Botërore” - kanë kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Zbatimit.

1.2 Interpretimi

(a) Në këtë Marrëveshje, përveç nëse paraqitet synimi që është qartas i kundërt:

(i) njëjësi përfshin shumësin, dhe anasjelltas;

- (ii) kalkulimet përveç çmimeve që duhet bërë në këtë kuadër do të shprehen në katër pikë decimale;
 - (iii) referencat në një Person përfshijnë pasardhësit e lejuar të atij Personi dhe të deleguarit por, nëse aplikohet, vetëm nëse këta pasardhës dhe të deleguar nuk janë të ndaluar me këtë Marrëveshje, dhe referencat në një Person në një cilësi të posaçme përjashton atë Person në një cilësi tjetër apo individualisht.
 - (iv) referencat në një gjini përfshin edhe gjininë tjetër;
 - (v) referencat në një marrëveshje, dokument, apo instrument nënkupton atë marrëveshje, dokument apo instrument me ndryshimet apo modifikimet përkatëse dhe në fuqi nga koha në kohë në pajtim me kushtet e saj, por me kusht që referenca në Standardet e Aplikueshme (përveç ligjeve të Kosovës) do të thotë Standardet e Aplikueshme (përveç ligjeve të Kosovës) në fuqi në Datën e Hyrjes në Fuqi dhe, pas ekzekutimit të Dokumenteve të Financimit, versioneve të Standardeve të Aplikueshme (përveç ligjeve të Kosovës) të kërkuara që të përmbushen nga çdo Kredithënës në kuadër të Dokumenteve të Financimit.
 - (vi) referencat në legjislacion ose dispozita tjera legjislative përfshijnë referencat në të gjitha modifikimet ligjore ose ri-miratimet e legjislacionit ose dispozitave të tilla ligjore, si dhe çdo legjislacion ose dispozitë legjislative e zëvendësuar për atë legjislacion ose dispozitë ligjore, me kusht që asgjë në këtë nen 1.2(a)(vi) të mos parandalojë një Palë të kërkojë ndryshim në ligj (siç përcaktohet në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë Elektrike) sipas përcaktimit në Marrëveshje të Projektit;
 - (vii) “këtu”, “nga kjo”, “në këtë” dhe fjalë të ngjashme do të konsiderohen si referenca në këtë Marrëveshje si tërësi dhe jo në ndonjë nen të veçantë, Shtojcë ose dispozitë tjetër, përveç nëse është cekur ndryshe në mënyrë specifike;
 - (viii) “duke përfshirë” (dhe me kuptimin reciprok “përfshin” ose “përfshihen”) do të thotë përfshirja pa kufizuar përgjithësinë e ndonjë përshkrimi që i paraprin shprehjes së tillë;
 - (ix) letër, dokument, ose instrument tjetër që përcakton se QK “nuk ka kundërshtim” (ose “nuk kundërshton” ose fjalë të tjera të ngjashme) në lidhje me një çështje të veçantë do të konsiderohen si pëlqim i QK në lidhje me atë çështje;
 - (x) në lidhje me përcaktimin e çdo periudhe kohore, “nga” do të thotë “nga dhe duke përfshirë” dhe “deri” do të thotë “deri por duke përjashtuar”;
 - (xi) referencat në dokumente, instrumente apo marrëveshje konsiderohen të jenë referenca edhe në të gjitha shtojcat, shtesat, dhe ndryshimet e tyre, dhe
 - (xii) referencat në një Palë për ta informuar apo për ta vënë në dijeni lidhur me një ngjarje a rrethanë do të konsiderohet t’i referohet stafit të asaj Pale që ka përgjegjësi për çështjet që kanë të bëjnë me atë ngjarje apo rrethanë, apo çdo drejtor apo zyrtar të tashëm apo të mëparshëm, i cili informohet apo vihet në dijeni.
- (b) Emërtimet dhe titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për referencë dhe nuk përbëjnë pjesë të substancës së kësaj Marrëveshje dhe nuk do të konsiderohen në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje.
- (c) Referencat brenda kësaj Marrëveshjeje në nenet, kapitujt dhe Shtojcat (dhe Shtesat e tyre) janë në nenet dhe kapitujt dhe Shtojcat (dhe Shtesat e tyre) të kësaj Marrëveshjeje, përveç nëse nuk është cekur ndryshe. Referencat në kuadër të Shtojcave në nenet, kapituj dhe anekset janë referenca në nene, kapituj dhe anekse të asaj Shtojce, përveç nëse nuk ceket ndryshe. Referencat në Shtojca

(apo anekse në to) në nenet dhe kapitujt e marrëveshjes janë referenca në këtë Marrëveshje, përveç nëse nuk ceket ndryshe.

- (d) Në kryerjen e obligimeve dhe detyrimeve të tyre, dhe në përcaktimin e vlerësimeve në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, secila Palë do të ketë një detyrim të nënkuptuar në mirëbesim.
- (e) Përveç nëse nuk ceket ndryshe në këtë Marrëveshje, referencat në kohë janë referenca në kohën standarde të Evropës Qendrore ose kohën verore të Evropës Qendrore, sipas aplikimit të atëhershëm në Lokacion.
- (f) Kjo marrëveshje është negociuar nga Palët përmes përfaqësimit juridik, dhe gjithashtu, çdo rregull interpretimi që kërkon ndryshe që kjo Marrëveshje të interpretohet kundër cilësdo Palë si palë hartuese nuk aplikohet për asnjë interpretim të saj.
- (g) Në masën që ekziston një konflikt ndërmjet çdo dispozite të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo Shtojce ose Aneksi, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të mbizotërojnë, por mungesa e një dispozite në një Shtojcë ose Aneks ose në këtë Marrëveshje (sipas rastit) nuk do të përbëjë konflikt.

Article 2

Data e hyrjes në fuqi; afati

2.1 Data e hyrjes në fuqi; afati

Kjo marrëveshje:

- (a) fillon dhe hyn në fuqi pas (i) datës së ekzekutimit, dhe (ii) datës në të cilën hyn në fuqi Marrëveshja për Blerje të Energjisë në pajtim me nenin 2.1 (hyrja në fuqi; afati) i Marrëveshjes për Blerje të Energjisë (ku kjo datë e hyrjes në fuqi do të jetë **“Data e hyrjes në fuqi”**); dhe
- (b) përveç nëse nuk zgjatet apo ndërpritet më herët në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, dhe sipas nenit 11.5, vazhdon në fuqi të plotë deri në ditën më të hershme të:
 - (i) arritjes së datës së operimit komercial; dhe
 - (ii) skadimit apo ndërprerjes paraprake të marrëveshjes së implementimit,(periudha e tillë, **“Afati”**).

Article 3

Pagesa e kapitalit

3.1 Kontributi

Sponsor HoldCo bie dakord që të kontribuojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, kapitalin (përfshirë përmes kredive aksionare) në GenCo si dhe kur kërkohet sipas Dokumenteve të Financimit.

3.2 Njoftimi i QK

GenCo pajtohet të informojë QK nëse ndonjë kapital që kërkohet të kontribuohet nga Sponsor HoldCo sipas Dokumenteve të Financimit nuk është kontribuar brenda tri (3) ditëve të punës pas datës së caktuar për këtë.

3.3 Certifikimi i kontributit

Deri në momentin që GenCo nuk ka dorëzuar tek QK certifikatën, të certifikuar nga auditorët e pavarur, që të gjitha shumat që kërkohet të kontribuohen nga Sponsor HoldCo sipas Dokumenteve të Financimit si kapital janë kontribuar në GenCo, QK do të ketë të drejtë të dorëzojë tek Sponsor HoldCo njoftim me shkrim se kontributi i kapitalit nga Sponsor HoldCo është i vonuar më shumë se tri (3) Ditë pune. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas pranimit nga Sponsor HoldCo të njoftimit të tillë, Sponsor HoldCo do të kontribuojë në mënyrë të pakushtëzuar dhe të përvokueshme tek GenCo shumën që më pas do të kontribuohet nga Sponsor HoldCo.

Article 4

Kufizimet në transferimin e interesave të pronësisë

4.1 Kufizimet në transferimin e interesave të pronësisë së Sponsorit

4.1.1 Pronësia dhe transferimet para përvjetorit të gjashtë

Deri në përvjetorin e gjashtë (6) të Datës së operimit komercial, Sponsor HoldCo duhet të

- (a) ketë në pronësi, të drejtpërdrejtë ose tërthortë, jo më pak se një qind për qind (100%) të Interesave të Pronësisë në GenCo;
- (b) bëjë që Sponsorin Përfundimtar:
 - (i) së bashku me filialet e saj në pronësi të plotë, të kenë jo më pak se pesëdhjetë e një për qind (51%) të interesave benefciale të pronësisë në GenCo; dhe
 - (ii) nuk do të transferojë ndonjë interes ligjor ose përfitues në Interesa të Pronësisë (ose të lejojë ndonjë Transferues të ndonjë Interesi të Pronësisë të mbajtur më parë nga Sponsor HoldCo) tek GenCo të regjistruar ose të mbajtur nga ai, përveç nëse:
 - (A) ky transferim nuk shkakton që Sponsorin Përfundimtar të ketë në pronësi jo më pak se pesëdhjetë e një për qind (51%) të interesave benefciale të pronësisë në GenCo; dhe
 - (B) brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas pranimit të të gjitha informatave të kërkuara sipas nenit 4.1.3(a), QK nuk ka kundërshtuar me shkrim transferimin në bazë të asaj se një transferim i tillë mund të pritët të ketë ndikim negativ në interesat e sigurisë kombëtare të QK.

4.1.2 Transferimet pas përvjetorit të gjashtë

Nga përvjetori i gjashtë e tutje nga data e operimit komercial:

- (a) Sponsor HoldCo do të ketë në pronësi, të drejtpërdrejtë ose tërthortë, jo më pak se një qind për qind (100%) të Interesave të Pronësisë në GenCo; dhe
- (b) Sponsorin përfundimtar mund të transferojë interesa benefcial në çdo Interes të Pronësisë në GenCo të regjistruar apo të mbajtur nga ai, me kusht që,
 - (i) nëse një transferim i tillë nuk shkakton Sponsorin Përfundimtar të ketë në pronësi më pak se pesëdhjetënjë për qind (51%) të Interesit benefcial të Pronësisë në GenCo, brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditëve të Punës pas pranimit të të gjitha informatave të kërkuara sipas nenit 4.1.3(a), QK nuk ka kundërshtuar me shkrim transferimin e mbi bazën se një transferim i tillë mund të pritët të ketë ndikim negativ në interesat e sigurisë kombëtare të QK; dhe
 - (ii) nëse transferimi i tillë shkakton Sponsorin Përfundimtar që të ketë në pronësi më pak se pesëdhjetënjë (51%) të Interesave benefciale të pronësisë në GenCo, brenda dyzetepesë (45) ditëve pas pranimit të të gjitha informatave të kërkuara sipas nenit 4.1.3, QK nuk ka kundërshtuar me shkrim transferimin e propozuar në bazë të aftësisë së asaj që përfituesi perspektiv i transferimit do të përmbush detyrimet financiare dhe menaxheriale si Sponsor Përfundimtar apo se ai transfer i tillë nuk mund të pritët që të ketë ndikimnegativ në interesat e sigurisë kombëtare të QK.

Sponsor HoldCo do të shaktojë që Sponsorit Përfundimtar të mos bëjë asnjë transfer të Interesit Beneficial të Pronësisë në GenCo përveçse në përputhje me këtë nen 4.1.2.

4.1.3 Informatat për vlerësimin e kapacitetit financiar dhe menaxherial dhe Sigurisë Kombëtare

Në lidhje me transferimin e propozuar nga Sponsorit Përfundimtar i një interesi Beneficial në çfarëdo Interesi të Pronësisë në GenCO të regjistruar ose të mbajtur nga ai, transferuesi perspektiv i interesit të tillë do ta njoftojë QK dhe do t'i japë QK-së informatat vijuese lidhur me transferimin e propozuar:

- (a) Për të gjitha transferimet e propozuara:
 - (i) emri i transferuesit të propozuar dhe identiteti i vendit në të cilin është ai është i organizuar;
 - (ii) emri dhe shtetësitë e të gjithë personave fizikë të cilët, sipas njohurisë së Sponsorit Përfundimtar, pas hulumtimit të duhur, ushtrojnë kontroll ose drejtpërdrejt apo tërthorazi kanë në pronësi njëzetepesë (25%) apo më shumë të transferuesit të propozuar; dhe
 - (iii) emrat dhe shtetin e organizimit të të gjithë personave që nuk janë persona fizikë (përveç kompanive të përkohshme holding) të cilët, sipas njohurisë së Sponsorit Përfundimtar, pas hulumtimit të duhur, ushtrojnë kontroll ose drejtpërdrejt apo tërthorazi kanë në pronësi dhjetë (10%) apo më shumë të transferuesit të propozuar; dhe
- (b) Përveç informacionit të specifikuar në nenin 4.1.3(a), për një transferim të propozuar që do të bënte që Sponsorit Përfundimtar të kishte në pronësi më pak se pesëdhjetënjë për qind (51%) të Interesit Beneficial të Pronësisë në GenCo:
 - (i) pasqyrat e audituara financiare për pesë (5) vitet e mëparshme fiskale, së bashku me pasqyrat financiare më të fundit të audituara tremujore;
 - (ii) një përshkrim të biznesit të tij, duke përfshirë një përshkrim të përvojës së tij me operimin e centraleve të linjimit ose thëngjillit; dhe
 - (iii) informata të tilla shtesë që mund të kërkohej në mënyrë të arsyeshme nga QK.

4.1.4 Transferimet e tjera të Lejuara

Kufizimet e mësipërme nuk zbatohen për:

- (a) transferimet e kerkuara me ligje të Kosovës ose me funksionimin e ligjeve të Kosovës ose me urdhrin e një gjykate, tribunali, ose autoriteti ose agjencie qeveritare me juridiksionin e duhur;
- (b) transferimet që rezultojnë nga krijimi ose ekzekutimi i një interesi të sigurisë në ose mbi çdo interes të pronësisë në përputhje me Dokumentet Financiare;
- (c) transferimet në të cilat QK ka dhënë miratimin paraprak me shkrim;
- (d) transferimet ndërmjet Sponsorit Përfundimtar dhe filialeve të Sponsorit Përfundimtar, që janë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në pronësi të plotë të Sponsorit Përfundimtar ose ndërmjet këtyre filialeve; me kusht që, sidoqoftë, filiali i tillë ka lidhur marrëveshje me QK që pranon të jetë i detyruar nga kushtet e kësaj Article 4; ose
- (e) çdo transfer që rezulton apo ndryshe përbën pengesë të lejuar (GenCo).

Article 5 Siguria e financimit

5.1 Siguria e financimit

Jo më vonë se data e hyrjes në fuqi, Sponsor HoldCo do t'i dorëzojë QK ose (i) një letër kredie të parevokueshme ("Letër Kredi Financiare") të lëshuar nga një Bankë e Kualifikuar që ka kushtet e

përcaktuara në Skemën1 apo (ii) para të gatshme apo çek në shumën e kërkuar të depozituar në një llogari të posaçme të QK (secila në **“Depozitë Financiare”**) ose (iii) çdo kombinim i një Letreje Financimi të Kredisë dhe Depozitë Financiare, në shumën maksimale totale të barabartë me shtatë milionë e pesëqind mijë Euro (€ 7,500,000) (së bashku **“Sigurimi i Financimit”**) Përveç nëse përcaktohet ndryshe këtu, Sponsor HoldCo do ta mirëmbajë në vazhdimësi Sigurimin e Financimit, apo një zëvendësim të tij, në fuqi dhe efekt të plotë në shumën e kërkuar deri në Datën e Transferimit. Në rast se Gjenerimi i KEK-ut ndërpret Marrëveshjen e Transferimit të Lokacionit në pajtim me nenin 5.4.2 (a) (*Ndërprerja nga Gjenerimi i KEK-ut*) me rastin e Ngjarjes së Konsideruar si Përmbyllje nga GenCo, atëherë do të ketë ndodhur një **“Ngjarja e Tërheqjes së Sigurimit të Financimit”** dhe QK mund të tërheqë Sigurimin e Financimit për shumën e plotë.

5.2 Obligimet e Sponsor HoldCo

Sponsor HoldCo:

- (a) heq dorë nga të gjitha të drejtat që mund t’i ketë për të kërkuar apo zbatuar urdhra të përkohshëm kufizimi të lidhur me Sigurimin e Financimit;
- (b) nëse është siguruar Letër Kredia e Financimit, jo më pak se tridhjetë (30) ditë para datës së cekur të skadimit të Letrës së Kredisë së Financimit në fuqi në atë kohë, do t’i dorëzojë QK-së:
 - (i) Sigurim Financimi zëvendësues që është i vlefshëm në atë datë të dorëzimit; dhe
 - (ii) Nëse zëvendësimi është po ashtu Letër Kredie e Financimit, një certifikatë nga një zyrtar i Sponsor HoldCo me datë sikurse ajo e dorëzimit, që certifikon se emetuesi i asaj Letër Kredie të Financimit që është zëvendësim i përmbush kriteret e Bankës së Kualifikuar, dhe se ajo Letër Kredi e Financimit i përmbush kërkesat e Skemës 1; dhe
- (c) do të dorëzojë në QK njoftimin brenda dhjetë (10) ditëve të punës për reduktimin e vlerësimit afatgjatë të borxhit të pasiguar të bankës emetuese të çdo Letër Kredie të Financimit nga S&P ose një institucion tjetër madhor ndërkombëtar rejtingu;
- (d) në rast se është siguruar një Letër Kredi e Financimit dhe lëshuesi i Letrës së Kredisë së Financimit më nuk i përmbush kualifikimet e një Banke të Kualifikuar brenda njëzet (20) Ditëve të Punës pas datës në të cilën GenCo informohet ose është dashur të ketë kuptuar në mënyrë të arsyeshme se emetuesi nuk i plotëson më kualifikimet e një banke të kualifikuar, do t’i dorëzojë QK-së Sigurimin zëvendësues të Financimit dhe, nëse zëvendësimi është gjithashtu Letër Kredi e Financimit, një certifikim nga një zyrtar i Sponsor HoldCo në datën e dërgesës, duke vërtetuar që:
 - (i) emetuesi i kësaj Letër Kredie zëvendësuese të Financimit i përmbush kërkesat e një Banke të Kualifikuar; dhe
 - (ii) kjo Letër Kredi e Financimit përmbush kërkesat e Skema 1.
- (e) në rast se Sigurimi i Financimit është në formën e parave të gatshme ose çekut, do të sigurojë paratë e gatshme ose çekun tek QK për depozitim në një llogari të veçantë të QK në emër të QK, dhe paraja e gatshme apo çeku nuk do të përzihen me fondet e tjera të QK ose aplikohen ndryshe nga QK deri në paraqitjen e një Ngjarjeje të Tërheqjes së Sigurimit të Financimit.

5.3 Zëvendësimi dhe anulimi i sigurimit

- (a) Brenda njëzet (20) Ditëve të Punës pas dorëzimit të Sigurimit të Financimit sipas nenit 5.2, QK do të dorëzojë Sigurimin e Financimit të zëvendësuar me Sigurimin zëvendësues të Financimit tek Sponsor HoldCo.
- (b) Në rast se Sponsor HoldCo nuk dorëzon zëvendësim të Sigurimit të Financimit siç kërkohet sipas kësaj Marrëveshjeje, do të ketë ndodhur Ngjarja e Tërheqjes së Dështimit të Zëvendësimit dhe QK, sipas gjykimit të saj, mund ta tërheqë çdo Letër Kredie Financiare në shumën e plotë të saj;

me kusht që, QK do të rimbursojë Sponsor HoldCo në shumën e tërhequr (pa interes ose dënim) brenda njëzet (20) ditëve të punës pas dorëzimit të zëvendësimit të Sigurimit të Financimit nga Sponsor HoldCo në pajtim me nenin 5.2. Pavarësisht nga sa më sipër, nëse Ngjarja e Tërheqjes së Sigurimit të Financimit do të ketë ndodhur para dorëzimit nga Sponsor HoldCo të çdo zëvendësimi të Sigurimit të Financimit sipas nenit 5.2, QK mund të aplikojë shumat e tërhequr në Sigurimin e Financimit sipas nenit 5.3(b) sikur të ishte tërhequr pas paraqitjes së Ngjarjes së Tërheqjes së Sigurimi Financiar.

- (c) Pas paraqitjes së datës së transferimit ose ndërprerjes nga GenCo të Marrëveshjes së Transferimit të Lokacionit në pajtim me nenin 5.4.1 (*Ndërprerja nga GenCo*) ose ndërprerja nga ose GenCo ose QK e Marrëveshjes për Transferimin e Lokacionit në pajtim me nenin 5.4.3 (*Ndërprerja për ndodhjen e Ngjarjes së Largimit nga QK dhe Ngjarjes që Konsiderohet si Largim i GenCo*), para datës së transferimit, QK do t'ia kthejë Sigurimin e Financimit GenCo pa kërkesë në të dh do t'i lirojë të gjitha të drejtat dhe interesat e tij.

Article 6

Fondi për zhvillimin e komunitetit

6.1 Fondi për zhvillimin e komunitetit

Sponsor HoldCo do të depozitojë ose sigurojë depozitim në Fondin e Zhvillimit të Komunitetit të themeluar në përputhje me Article 10 (*Fondi i Zhvillimit të Komunitetit, Paneli i Fondit të Zhvillimit të Komunitetit, Procedurat e Zhvillimit të Komunitetit*) të Marrëveshjes së Zbatimit në ose para Datës së Transferimit një milion euro e gjysmë (1.500.000 €); me kusht që Palët pranojnë dhe pajtohen që nëse Marrëveshja e Zbatimit është ndërprerë për shkak të një Ngjarjes së Dështimit të QK (siç përcaktohet në Marrëveshjen e Zbatimit), atëherë, në datën e përfundimit të tillë (i) Sponsor HoldCo nuk do të ketë detyrime të mëtejshme ose detyrime për të bërë depozita në Fondin e Zhvillimit të Komunitetit dhe (ii) bilanci që kërkohet të depozitohet në Fondin e Zhvillimit të Komunitetit nga Sponsor HoldCo do të jetë i barabartë me zero Euro (€ 0).

Article 7

Dështimi

7.1 Ngjarjet e dështimit të Sponsor HoldCo

Secila nga pikat vijuese përbën rast të shkeljes nga Sponsor HoldCo (ku secili prej këtyre është “**Rast i Shkeljes nga Sponsor HoldCo**”):

- (a) dështimi nga Sponsor HoldCo për të bërë kontribute të kapitalit në GenCo sipas kësaj marrëveshjeje që Sponsor HoldCo nuk ka rregulluar këtë dështim brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditësh pas pranimit nga Sponsor HoldCo të njoftimit me shkrim nga QK për mospagesën e tillë, njoftim ky që do të specifikojë dështimin e kontributit në hollësi të arsyeshme; me kusht që asnjë pagesë që është e detyruar si pasojë e zgjidhjes së një Kontesti Pagesash, Kontesti Teknik, apo ndonjë Kontesti tjetër nuk konsiderohen borxh për qëllimet e këtij Seksioni 7.1(a) deri në pesëmbëdhjetë (15) Ditë Pune pas zgjidhjes pas zgjidhjes së atij kontesti;
- (b) paraqitja e një shkeljeje nga Sponsor HoldCo ose Sponsor Përfundimtar lidhur me kufizimet mbi pronësinë ose transferimin e Interesit të Pronësisë që përcaktohet në Article 4;
- (c) dështimi nga Sponsor HoldCo për të dorëzuar ose për të mbajtur rregullisht Sigurimin e Financimit siç kërkohet me këtë Marrëveshje që Sponsor HoldCo nuk ka rregulluar brenda njëzet (20) ditëve të punës pas marrjes së njoftimit me shkrim nga QK për Sponsor HoldCo për paraqitjen e dështimit të tillë;
- (d) paraqitja e një Ngjarjeje Financiare të Tërheqjes të Sigurisë;

- (e) dështimi nga Sponsor HoldCo për të financuar Fondin e Zhvillimit të Komunitetit siç kërkohet me këtë Marrëveshje;
- (f) Dështimi nga Sponsor HoldCo në cilindo aspekt në respektimin apo përmbushjen e ndonjë obligimi tjetër material të Mihjes së KEK-ut të parapara me këtë Marrëveshje që Sponsor HoldCo nuk ka filluar brenda tridhjetë (30) Ditësh pas pranimit nga Sponsor HoldCo të njoftimit me shkrim nga QK, ku specifikohet dështimi në detaje të arsyeshme dhe me kërkesën që ky të sanohet; me kusht, megjithatë, që nëse Sponsor HoldCo fillon marrjen e veprimeve të përshtatshme për të sanuar atë dështim brenda tridhjetë (30) Ditësh, si dhe më pastaj vazhdon me vigjilencë të sanojë atë dështim, periudha e sanimit do të zgjatet për një periudhë plotësuese prej nëntëdhjetë (90) Ditësh; dhe
- (g) paraqitja e ngjarjeve të shkeljeve nga Sponsor HoldCo të detyrimeve të tij sipas nenit 11.14; me kusht, megjithatë, që asnjë rast i tillë të mos jetë Rast i Shkeljes nga Sponsor HoldCo dhe Sponsor HoldCo do të lirohet nga përmbushja sipas kësaj Marrëveshjeje nëse shkaktohet si e tërë apo në masë të madhe nga QK apo nga dështimi i QK sipas kësaj Marrëveshjeje:

Me kusht që detyrimet e Sponsor HoldCo sipas kësaj Marrëveshjeje janë gjithashtu detyrim i Sponsor HoldCosipas cilësdo Marrëveshje të Projektit, atëherë secili sanim, zgjidhje apo falje e shkeljes së atij obligimi sipas Marrëveshjes së zbatueshme të Projektit përbën sanim, zgjidhje apo falje sipas asaj Marrëveshjeje nëse QK ka pranuar njoftim të arsyeshëm paraprak të atij sanimi, zgjidhjeje apo faljeje të propozuar të atij obligimi sipas Marrëveshjes së zbatueshme të Projektit dhe ka dështuar të kundërshtojë me arsye atë sanim, zgjidhje apo falje brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

Sponsor HoldCo mund të sanojë Rastet e Shkeljes nga Sponsor HoldCo duke mundësuar që Kontraktuesi i Sponsor HoldCo të sanojë atë Rast të Shkeljes nga Sponsor HoldCo.

Article 8

Zotimet dhe garancitë

8.1 Zotimet dhe garancitë e GenCo-s

GenCo zotohet dhe i garanton Palëve të tjera që në datën e Ekzekutimit:

- (a) GenCo është entitet i organizuar ligjërisht, ekziston ligjërisht, si dhe në pozitë të rregullt sipas ligjeve të Luksemburgut; me kusht, megjithatë, që në riafirmimet e dhëna nga GenCo sipas nenit 8.4, GenCo duhet të zotohet dhe t'i garantojë QK që GenCo entitet i organizuar ligjërisht, ekziston ligjërisht, si dhe në pozitë të rregullt sipas ligjeve të Kosovës;
- (b) Ekzekutimi, zbatimi dhe përmbushja e kësaj Marrëveshjeje nga GenCo është autorizuar ligjërisht me të gjitha veprimet e kërkuara korporative, si dhe GenCo ka autorizim të plotë korporativ dhe autoritet për të ekzekutuar, zbatuar dhe përmbushur të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje;
- (c) Kjo Marrëveshje përbën detyrim ligjor, të vlefshëm dhe obligativ të GenCo-s, të përbarueshëm ndaj saj në pajtim me kushtet e Marrëveshjes, sa i përket zbatueshmërisë së mjeteve juridike, kufizimeve të vendosura me bankrotim, paaftësi pagese, riorganizim, moratorium apo ligje të tjera të ngjashme në fuqi, që kanë të bëjnë me apo ndikojnë në përbarimin e të drejtave të kreditorëve në përgjithësi, si dhe parimet e përgjithshme të ekuitetit;
- (d) Ekzekutimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje nuk është në kundërtënie me asnjë dispozitë, e as nuk përbën shkelje, të ndonjë pengu, hipoteke, apo ndonjë marrëveshjeje materiale që është obligative për GenCo-n, apo ndonjë urdhri valid të ndonjë gjykate, apo ndonjë agjencie rregullative apo ndonjë organi kompetent veprimeve të të cilit i nënshtrohet GenCo; si dhe
- (e) Asnjëra prej ekzekutimit, zbatimit apo përmbushjes nga GenCo të kësaj Marrëveshjeje, përputhshmëria me kushte dhe dispozitat e saj, si dhe kryerja e transaksioneve të parapara me Marrëveshje, nuk është në konflikt e as nuk do të jetë në konflikt e as të rezultojë me shkelje apo

kundërvajtje e GenCo ndaj Dokumenteve Themeltare apo ndonjë prej kushteve, afateve apo dispozitave të cilitdo Ligj të Kosovës apo ndonjë leje të vlefshme, apo ndonjë urdhër, vendim, masë të përkohshme, aktgjykim apo dekret të ndonjë Autoriteti Publik ndaj GenCo-s.

8.2 Zotimet dhe garancitë e Sponsor HoldCo

Sponsor HoldCo zotohet dhe i garanton Palëve të tjera që në datën e Ekzekutimit:

- (a) Sponsor HoldCo është entitet i organizuar ligjërisht, ekziston ligjërisht, si dhe është në pozitë të mirë sipas Ligjeve të Luksemburgut;
- (b) Ekzekutimi, zbatimi dhe përmbushja e kësaj Marrëveshjeje nga Sponsor HoldCo është autorizuar ligjërisht me të gjitha veprimet e kërkuara korporative, si dhe Sponsor HoldCo ka autorizim të plotë korporativ dhe autoritet për të ekzekutuar, zbatuar dhe përmbushur të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje;
- (c) Kjo Marrëveshje përbën detyrim ligjor, të vlefshëm dhe obligativ të Sponsor HoldCo, të përmbarueshëm ndaj secilës në pajtim me kushtet e Marrëveshjes, sa i përket zbatueshmërisë së mjeteve juridike, kufizimeve të vendosura me bankrotim, paaftësi pagese, riorganizim, moratorium apo ligje të tjera të ngjashme në fuqi, që kanë të bëjnë me apo ndikojnë në përmbarimin e të drejtave të kreditorëve në përgjithësi, si dhe parimet e përgjithshme të ekuitetit;
- (d) Ekzekutimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje nuk janë në kundërtënie me asnjë dispozitë, e as nuk përbën shkelje, të ndonjë pengu, hipoteke, apo ndonjë marrëveshjeje materiale që është obligative për Sponsor HoldCo, apo ndonjë urdhri valid të ndonjë gjykate, apo ndonjë agjencie rregullative apo ndonjë organi kompetent veprimeve të të cilit i nënshtrohet Sponsor HoldCo;
- (e) Asnjëra prej ekzekutimit, zbatimit apo përmbushjes nga Sponsor HoldCo të kësaj Marrëveshjeje, përputhshmëria me kushte dhe dispozitat e saj, si dhe kryerja e transaksioneve të parapara me Marrëveshje, nuk është në konflikt e as nuk do të jetë në konflikt e as të rezultojë me shkelje apo kundërvajtje ndaj Dokumenteve Themeltare apo ndonjë prej kushteve, afateve apo dispozitave të cilitdo Ligj të Kosovës apo ndonjë leje të vlefshme, apo ndonjë urdhër, vendim, masë të përkohshme, aktgjykim apo dekret të ndonjë Autoriteti Publik ndaj Sponsor HoldCo.
- (f) Sponsor HoldCo nuk është në kundërvajtje ndaj ndonjë marrëveshjeje apo instrumenti të asnjë natyre në të cilën është Palë apo për të cilën është i detyruar, në asnjë mënyrë që të ketë efekt negativ në zotësinë e tij për të përmbushur obligimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, vlefshmërinë apo përmbarimin e kësaj Marrëveshjeje; dhe
- (g) Nuk ka ndonjë mjet juridik, padi, procedurë apo hetim në vazhdim, apo në njohuritë e Sponsor HoldCo, që kërcënon:
 - (i) shpërbërjen e Sponsor HoldCo;
 - (ii) përfshirjen e mospagesave të Sponsor HoldCo të:
 - (A) tatimeve ndaj çdo autoriteti publik; apo
 - (B) çdo borxhi ndaj personi që është:
 - (1) shtetas ose i organizuar sipas ligjeve të Kosovës; ose
 - (2) në kontroll të të QK, KESCO, apo një NP të specifikuar; ose
 - (iii) ndryshe ndaj Sponsor HoldCo

Që nëse vendoset në dëm të saj, do të kishte efekt material negativ në zotësinë e saj për të përmbushur obligimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje ose në vlefshmërinë apo përmbarimin e kësaj Marrëveshjeje.

8.3 Zotimet dhe garancitë e QK

QK zotohet dhe i garanton Palëve të tjera që në datën e Ekzekutimit:

- (a) kjo Marrëveshje është autorizuar, ekzekutuar dhe realizuar nga QK dhe përbën detyrim ligjor, të vlefshëm dhe obligativ të QK, të përmbarueshëm ndaj saj në pajtim me kushtet e Marrëveshjes, sa i përket zbatueshmërisë së mjeteve juridike, kufizimeve të vendosura me bankrotim, paaftësi pagese, riorganizim, moratorium apo ligje të tjera të ngjashme në fuqi, që kanë të bëjnë me apo ndikojnë në përmbarimin e të drejtave të kreditorëve në përgjithësi, si dhe parimet e përgjithshme të ekuitetit;
- (b) Ekzekutimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje nuk është në kundërtënie me asnjë dispozitë, e as nuk përbën shkelje, të ndonjë pengu, hipoteke, apo ndonjë marrëveshjeje materiale që është obligative për QK, apo ndonjë urdhri valid të ndonjë gjykate, apo ndonjë agjencie rregullative apo ndonjë organi kompetent veprimeve të të cilit i nënshtrohet QK;
- (c) Asnjëra prej ekzekutimit, zbatimit apo përmbushjes nga QK të kësaj Marrëveshjeje, përputhshmëria me kushte dhe dispozitat e saj, si dhe kryerja e transaksioneve të parapara me Marrëveshje, nuk është në konflikt e as nuk do të jetë në konflikt e as të rezultojë me shkelje apo kundërvajtje ndaj kushteve, afateve apo dispozitave të cilitdo Ligj të Kosovës apo ndonjë leje të vlefshme, apo ndonjë urdhër, vendim, masë të përkohshme, aktgjykim apo dekret të ndonjë Autoriteti Publik ndaj QK; dhe.
- (d) QK nuk është në kundërvajtje ndaj ndonjë marrëveshjeje apo instrumenti të asnjë natyre në të cilën është Palë apo për të cilën është i detyruar, në asnjë mënyrë që të ketë efekt negativ në zotësinë e tij për të përmbushur obligimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, vlefshmërinë apo përmbarimin e kësaj Marrëveshjeje;

8.4 Riafirmimi i zotimeve dhe garancive

Datën e hyrjes në fuqi, GenCo do të dorëzojë një certifikatë në QK duke konfirmuar se zotimet dhe garancitë në nenin 8.1 janë të vërteta dhe të sakta deri në atë datë, Sponsor HoldCo do të dorëzojë një certifikatë në QK që konfirmon se zotimet dhe garancitë në nenin 8.2 janë të vërteta dhe të sakta në atë datë, dhe QK do të dorëzojë një certifikatë për GenCO dhe Sponsor HoldCo që konfirmon se zotimet dhe garancitë në nenin 8.3 janë të vërteta dhe të sakta në atë datë.

Article 9

Kufizimi i përgjegjësisë

9.1 Kufizimi i përgjegjësisë

- (a) Përveç nëse shprehimisht parashihet e kundërta me këtë Marrëveshje, asnjëra palë nuk mban përgjegjësi ndaj Palës tjetër me kontratë, detyrim, garanci, përgjegjësi strikte, apo sipas ndonjë instrumenti tjetër ligjor për asnjë lloj dëmi indirekt, pasues, incidental, ndëshkues apo ekzemplar. Pagesat që i detyrohen njërës Palë nga ndonjë palë e tretë konsiderohen dëme direkte, si dhe nuk përjashtohen nga dispozitat paravajtëse të këtij neni 9.1(a), përveç në lidhje me kontratat (të tjera nga Kontrata OEM dhe Marrëveshja për Shërbime Administrative (e përcaktuar në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë) dhe Marrëveshjet LTM të miratuara nga NKEC-ja sipas neni 3 (*Obligimet para ndërtimit*) të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë) ndërmjet GenCo-s në njërën anë dhe palë të lidhura me Sponsorin Ultimativ si palë homologe të GenCo-s (të cilat përjashtohen nga dispozitat paravajtëse të këtij neni 9.1).
- (b) Asnjëra Palë nuk mban përgjegjësi ndaj Palës tjetër, përveç në bazë të, apo për shkelje të kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë Marrëveshjeje të Projektit që ka lidhur; me kusht, megjithatë, që kjo dispozitë nuk mëton të përbëjë heqje dorë nga të drejtat e njërës Palë ndaj tjetrës, sa i përket çështjeve që nuk lidhen me këtë Marrëveshje apo ndonjë aktivitet që nuk parashihet me këtë Marrëveshje, si dhe kjo dispozitë nuk mëton të kufizojë apo t'i mohojë GenCo-s të drejtën për të

(i) kërkuar dhe fituar të gjitha të ardhurat e humbura shprehimisht të parapara me nenin 20 (*të drejtat dhe obligimet pas ndërprerjes; kompensimi*) të Marrëveshjes së Implementimit, apo me ndonjë marrëveshje tjetër të projektit që mundëson atë kthim , ose (ii) zhdëmtuar dhe/ose rikuperuar kostot në lidhje me Gjendet Mjedisore/Arkeologjike (të përcaktuar në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë) të parapara me ndonjë Marrëveshje të Projektit.

Article 10

Garancia e sponsorit përfundimtar

10.1 Garancia e sponsorit përfundimtar

Më apo para datës së hyrjes në fuqi, Sponsorit Përfundimtar ekzekuton dhe dorëzon në QK Garancinë e Sponsorit Përfundimtar.

Article 11

Të ndryshme

11.1 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Dispozitat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të nenit 22 (*Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*) të Marrëveshjes së Zbatimit janë të inkuorporuara në këtë Marrëveshje, *mutatis mutandis*.

11.2 Njoftimet

(a) Të gjitha njoftimet dhe komunikimet tjera të kërkua apo lejuara për t'u dhënë nga një Palë (përfshirë faturat që kërkohen apo lejohen të dorëzohen këtu) duhet të bëhen me shkrim si dhe të dorëzohen ose personalisht ose me postë të shpejtë ose të dërgohen me faks apo email në adresën apo numrin e Palës tjetër të specifikua si më poshtë:

(i) Nëse për QK:

Qeveria e Kosovës
Rr. Nene Tereza36
Pristina, Kosovo
Për vëmendjen e: Blerand Stavileci
Tel: [_____]
Faks: [_____]
E-mail: [_____]

(ii) Nëse për Sponsor HoldCo:

ContourGlobal Terra 6 S.à r.l.
35-37 Avenue de la Liberté
L-1931 Luxembourg, Grand Duchy of Luxembourg
Attention: The board of managers
Tel: + (352) 28 86 78 00
Fax: + (352) 24 52 73 26
E-mail: CGK_CEO@contourglobal.com and
CGK_GC@contourglobal.com

(iii) Nëse për GenCo:

ContourGlobal Terra 6 S.à r.l.
35-37 Avenue de la Liberté
L-1931 Luxembourg, Grand Duchy of Luxembourg
Për: The board of managers
Tel: + (352) 28 86 78 00

Faks: + (352) 24 52 73 26
E-mail: CGK_CEO@contourglobal.com and
CGK_GC@contourglobal.com

me kusht që Pala mund të ndryshojë adresën ku duhen dërguar njoftimet, duke dhënë njoftim paraprak me shkrim së paku tridhjetë (30) Ditë përpara për Palën tjetër në pajtim me këtë nen 11.2(a).

- (b) Asnjë njoftim e as komunikim nuk është efektiv deri sa të pranohet apo të konsiderohet i pranuar. Njoftimet apo komunikimet tjera konsiderohen të jenë pranuar nga Pala pranuese:
- (i) Kur dorëzohen, nëse dorëzohen personalisht;
 - (ii) Tri (3) Ditë Pune pas dërgimit, nëse dërgohen me postë të shpejtë ndërkombëtare;
 - (iii) Pas dërgimit, nëse dërgohen me faks, pas një konfirmimi të raportit të transmetimit të pandërprerë, si dhe me kusht që kopja në letër të dorëzohet jo më vonë se Dita vijuese e Punës tek pranuesi me postë të shpejtë ndërkombëtare ose dorëzim personal; ose
 - (iv) Pas dërgimit, nëse dërgohet me e-mail, me kusht që që kopja në letër të dorëzohet jo më vonë se Dita vijuese e Punës tek pranuesi me postë të shpejtë ndërkombëtare ose dorëzim personal; me kusht, megjithatë, që Palët munden, kohë pas kohe, të pajtohen bashkë me shkrim që nuk nevojiten kërkesat për dorëzim të kopjes në letër, duke marrë parasysh komunikimet operationale të përditshme apo në rutinë të ngjashme.
- (c) Pala që dorëzon njoftimin apo ndonjë komunikim tjetër në pajtim me nenin 11.2(a) duhet që të bëjë përpjekje të arsyeshme komerciale për t'i siguruar Palës pranuese përkthim arsyeshëm të saktë në gjuhën shqipe brenda pesë (5) Ditësh Pune pas dërgimit të atij njoftimi apo komunikimi tjetër në gjuhën angleze; me kusht, megjithatë, që Pala nuk do të jetë e detyruar të ofrojë përkthimin e skicave teknike apo dokumenteve inxhinierike. Në rast të mospërputhjeve ndërmjet origjinalit në anglisht dhe përkthimit në shqip të njoftimit apo komunikimeve të tjera, versioni anglisht do të mbizotërojë mbi versionin shqip. Për të shmangur dyshimet, dështimi në dorëzim të përkthimit të njoftimit apo komunikimeve tjera në pajtim me këtë nen 11.2(c) nuk e ndikon efektshmërinë e atij njoftimi apo komunikimeve tjera sipas përcaktimit të nenit 11.2(b).
- (d) Në rast se njoftimi i dorëzuar nga GenCo apo Sponsor HoldCo tek QK sipas kësaj Marrëveshjeje obligon QK ose të japë përgjigje (përfshirë aprovimet apo mos-kundërshtimet) brenda një periudhe të caktuar kohore apo të konsiderohet të ketë aprovuar apo të mos ketë kundërshtuar marrjen e veprimeve nga GenCo apo Sponsor HoldCo, GenCo do të përfshijë në atë njoftim edhe përshkrimin e periudhës së përgjigjes si dhe pasojat e dështimit të QK në përgjigje (përfshirë aprovimin apo mos-kundërshtimin e konsideruar si të tillë).

11.3 Ndryshimet

Ndryshimet apo modifikimet e kësaj Marrëveshjeje hyjnë në fuqi apo bëhen detyruese ndaj Palës vetëm nëse bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga përfaqësuesi i autorizuar i secilës Palë; me kusht, megjithatë, që ndryshimi i tillë të mos ndikojë në obligimet e QEK-së sipas Kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë Marrëveshjeje tjetër të Projektit, përveç nëse QEK-ja është palë e marrëveshjes për ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje (apo versionit të ndryshuar dhe të rishkruar të kësaj Marrëveshjeje), apo nëse QEK-ja ndryshe ka dhënë pëlqimin e për ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje.

11.4 Bashkëpunimi, ndihma dhe informimi nga QK

QK duhet të respektojë dispozitat e nenit 3.2 (*Pa Diskriminim; Pa Shpronësim*), neni 3.4.2 (*Mbështetja në financim*), neni 3.4.3 (*Pëlqimi për caktimin kolateral*), si dhe neni 4.4 (*Mbështetja e QEK-së në marrje të pëlqimeve*) të Marrëveshjes së Implementimit sikur ato dispozita të ishin të vlefshme për QK dhe të ishin pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

11.5 Mbijetesa

- (a) Me skadimin e kësaj Marrëveshjeje apo shkëputjen e mëhershme të kësaj Marrëveshjeje, të gjitha pajtimet, detyrimet, zotimet, dhe garancitë e kësaj Marrëveshjeje përfundojnë dhe nuk kanë më fuqi a efekt, si dhe Palët nuk kanë më obligime apo përgjegjësi sipas kësaj Marrëveshjeje; me kusht, megjithatë, që pikat vijuese shprehimisht vazhdojnë të mbijetojnë: (i) ato obligime dhe përgjegjësi që kanë lindur para dhe mbesin të papërbushura në datën e skadimit apo shkëputjes, si dhe (ii) ato obligime dhe përgjegjësi që shprehimisht mbijetojnë pas skadimit apo shkëputjes sipas nenit 11.5(b).
- (b) Pavarësisht të gjitha atyre të përfshira në këtë Marrëveshje që është ndryshe, dispozitat e nenit 1 (*Përkufizimet; Interpretimi*), nenit 4 (*Kufizimet në transferimin e interesave të pronësisë*), nenit 9 (*Kufizimi i detyrimit*), dhe nenit 11 (*Të ndryshme*) mbijetojnë shprehimisht çdo ndërprerje apo skadim të kësaj Marrëveshjeje, me kusht që obligimet dhe detyrimet në kuadër të nenit 4 (*Kufizimet në transferimin e interesave të pronësisë*) ndërprejnë dhe nuk kanë fuqi apo efekt pas (a) skadimit apo ndërprerjes paraprake të Marrëveshjes së Zbatimit dhe (b) mbylljes së Datës së Blerjes, cilado është më vonë.

11.6 Palët e Treta Përfituese

Përveç të drejtave të cekura shprehimisht në këtë Marrëveshje, kjo Marrëveshje është menduar vetëm për përfitim të Palëve dhe asgjë në të nuk interpretohet për të krijuar ndonjë të drejtë, detyrim, standard të kujdesit apo përgjegjësi ndaj çdo personi që nuk është Palë.

11.7 Nuk ka Heqje Dorë

Nuk mund të hiqet dorë apo largohet asnjë dështim nga Palët në kryerjen apo përbushjen e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje përveç me pëlqimin e shprehur me shkrim të Palës tjetër. Asnjë lloj heqje dorë nga cilado Palë ndaj kundërvajtjes së Palës tjetër në përbushje apo respektim të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nuk mund të veprojë e as të merret si heqje dorë nga diçka tjetër apo nga ndonjë kundërvajtje tjetër, të një natyre të ngjashme apo të ndryshme.

11.8 Marrëdhënia mes Palëve

- (a) Kjo Marrëveshje nuk është dhe nuk mund të interpretohet apo të merret që krijon një asocim, sipërmarrje të përbashkët apo partneritet mes Palëve, apo që të imponojë ndonjë detyrim ortakërie apo ndonjë përgjegjësi të ngjashme ndaj cilësdo Palë.
- (b) Asnjëra Palë nuk ka të drejtë, fuqi apo autoritet të lidhë marrëveshje apo sipërmarrje për, të veprojë në emër të, apo të jetë agjent a përfaqësues, apo ndryshe të obligojë, Palën tjetër, si dhe asnjëra Palë nuk do ta konsiderojë ndonjë palë të tretë si bartëse të të drejtës, fuqisë apo autoritetit të tillë.

11.9 Shpenzimet e Palëve

Përveç sipas dakordimit tek Neni 16 (*Tarifat e Këshilltarëve dhe Inxhinierëve para dhe pas Përmblylljes Financiare*) të Marrëveshjes së Implementimit apo siç mund të lidhet në ndonjë Marrëveshje tjetër Projekti, ndërmjet Palëve të kësaj Marrëveshjeje, të gjitha shpenzimet e pësuara nga apo në emër të Palës, përfshirë tarifat dhe shpenzimet e agentëve, përfaqësuesve, këshilltarëve dhe kontabilistëve të punësuar nga Palët në lidhje me përgatitjen e kësaj Marrëveshjeje dhe konsumimit të transaksioneve të trajtuara me këtë Marrëveshje, do të barten ekskluzivisht nga Pala që ka pësuar ato shpenzime, ndërsa Pala tjetër nuk ka përgjegjësi në lidhje me to.

11.10 Pëlqimi

Përveç nëse parashihet ndryshe këtu, kurdo që kërkohet pëlqimi apo aprovimi nga Pala nga Pala tjetër, pëlqimi apo aprovimi i tillë duhet të jetë me shkrim, si dhe nuk mund të pengohet, kushtëzohet, apo vonohet pa arsye.

11.11 Gjuha

Kjo Marrëveshje është hartuar në gjuhën angleze, si dhe versioni në anglisht mbizotëron mbi çdo përkthim. Të gjitha njoftimet, vërtetimet dhe dokumentet e komunikimit tjera (përfshirë kopjet) e dhëna apo të hartuara sipas apo në lidhje me këtë Marrëveshje do të jenë në anglisht.

11.12 Ligji Qeverisës

Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në pajtim me ligjet e Shtetit të Nju-Jorkut.

11.13 Tërësia

Kjo Marrëveshje do të jetë shprehja e plotë dhe përfundimtare e dakordimit mes Palëve mbi çështjet e trajtuara këtu. Përveç Marrëveshjeve të tjera të Projektit dhe dakordimeve apo komunikimeve të kërkuara këtu, të gjitha zotimet, mirëkuptimet, ofertat apo komunikimet tjera të cilitdo lloj, me shkrim apo me gojë, mes Palëve në lidhje me Projektin Kosova e Re para kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë Memorandumin e Mirëkuptimit, shfuqizohen dhe tërhiqen.

11.14 Caktimi

- (a) Brenda gjashtëdhjetë (60) Ditësh nga ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje, GenCo mund t'ia caktojë të drejtat, titujt dhe interesat brenda dhe mbi, si dhe të delegojë obligimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje, CG Kosovës. Për më tepër, Sponsor HoldCo apo Sponsor Përfundimtar dhe GenCo mund t'ia bartë si kolateral interesat e saj sipas kësaj marrëveshjeje Huadhënësit apo ndonjë Personi tjetër në lidhje me ushtrimin e të drejtave kolaterale të Huadhënësit. Përveç sipas lejimit të shprehur sipas këtij neni 11.14(a), kjo Marrëveshje nuk mund të caktohet nga Sponsor HoldCo, Sponsor Përfundimtar apo GenCo tek asnjë palë tjetër pa pëlqimin paraprak me shkrim të QK.
- (b) Kjo Marrëveshje nuk do të caktohet nga QK pa miratimin paraprak me shkrim të Sponsor HoldCo, Sponsor Përfundimtar dhe GenCo.
- (c) Kjo Marrëveshje obligon dhe vlen për dobi të Palëve dhe çdo pasardhës apo të autorizuar që përfiton një interes sipas kësaj Marrëveshjeje në pajtim me nenin 11.14(a) dhe nenin 11.14(b).
- (d) Çdo transferim në kundërshtim me këtë nen 11.14 do të jetë nul dhe i pavlefshëm.

11.15 Konfidencialiteti

- (a) Sipas nenit 11.15(d), kjo Marrëveshje dhe të gjitha informatat e paraqitura këtu apo në lidhje me këtë Marrëveshje do të trajtohen si konfidenciale, si dhe në pajtim me nenin 11.15(c) informatat e tilla nuk mund të zbulohen, tërësisht apo pjesërisht, nga cilado Palë, pa pëlqimin paraprak të Palës tjetër.
- (b) Ky obligim nuk vlen për informatat që (kur përdoren apo zbulohen) janë bërë publike në mënyrë tjetër që nuk është shkelje e kësaj Marrëveshjeje, apo është marrë, apo ka mundur të jetë marrë, ligjërisht nga Pala.
- (c) Duke mos anashkaluar dispozitat e nenit 11.15(a), asnjëra Palë nuk obligohet të marrë pëlqimin paraprak të palës tjetër në lidhje me zbulimin e informatave:
 - (i) Para drejtorëve dhe punëtorëve të degëve të ndërlidhura të asaj Pale, me kusht që ajo Palë të ketë bërë përpjekje të arsyeshme për të siguruar që degët e tilla të ndërlidhura të ruajnë

konfidencialitetin e informatave të zbuluara me të njëjtat kushte si ato që parashihen me këtë paragraf 11.15;

- (ii) Para Personave që profesionalisht janë angazhuar nga apo në emër të asaj Pale (duke përfshirë këshilltarët, konsulentët dhe agjentët sigurues të saj); me kusht që Personat e tillë të obligohen nga ajo Palë të ruajë konfidencialitetin e informatave të tilla si dhe që ajo Palë të bëjë përpjekje të arsyeshme për të siguruar respektimin e zotimit të tillë;
 - (iii) Para ndonjë departamenti qeveritar apo ndonjë agjencie qeveritare apo rregullative që ka juridiksion mbi atë Palë, por vetëm deri në masën që ajo Palë është e obliguar me ligj që të bëjë zbulimin e tillë;
 - (iv) për:
 - (A) çfarëdo institucioni huadhënës apo tjetër financiar, përfshirë Grupin e Bankës Botërore, në lidhje me financimin apo rifinancimin e operacioneve të asaj Pale, dhe në çdo rast, këshilltarëve, konsulentëve dhe siguruesve të tyre në lidhje me financimin apo rifinancimin;
 - (B) Çfarëdo agjencie vlerësimi (rejtingu), si dhe këshilltarëve, konsulentëve dhe siguruesve të tyre;
 - (C) Çfarëdo investitori aktual apo potencial të ekuitetit, si dhe në çdo rast, këshilltarëve, konsulentëve dhe siguruesve të tyre; ose
 - (D) Çfarëdo pale pranuese të bartjes apo caktimit bona fide (si dhe në çdo rast, këshilltarëve, konsulentëve dhe siguruesve të tyre) të të gjithë apo një pjese të të drejtave dhe interesave të Palës zbuluese sipas kësaj Marrëveshjeje,
- Por (në secilin rast) vetëm deri në masën e nevojshme në lidhje me sigurimin e atij financimi, rifinancimi, rejtingu, investimi në ekuitet, apo në lidhje me caktimin e propozuar si dhe duke pasur parasysh Personin e tillë apo të caktuarin apo të barturin që pajtohet me atë Palë që të obligohet me dispozitat e konfidencialitetit që janë substancialisht të njëjta me ato që parashihen me këtë nen 11.15; ose
- (v) Para ndonjë eksperti apo arbitri të emëruar në bazë të si dhe sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje.
- (d) Duke mos anashkaluar dispozitat e paragrafit 11.15(a), Palët pajtohen që (i) QEK-ja mund ta shpallë këtë Marrëveshje dhe cilëndo prej Marrëveshjeve tjera të Projektit para publikut në çdo moment pas Datës së Bartjes (por vetëm deri në masën që ajo shpallje të jetë e kërkuar me Ligjet e zbatueshme të Kosovës apo politikat e publikimit të QEK-së, si dhe me kusht që informatat e ndjeshme komerciale të redaktohen deri në masën ligjërish të lejueshme), si dhe (ii) që palët, QEK dhe degët e tyre të Ndërlidhura mund të ndajnë secilën Marrëveshje Projekti në pajtim me dispozitat e secilës prej atyre Marrëveshjeve të Projektit. Pas shpalljes së kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë pjese të saj para publikut nga QEK, kufizimet e përcaktuara me këtë paragraf 11.15 nuk vlejné më për GenCo-n në lidhje me informatat e tilla të shpallura për publikun.

11.16 Mjetet juridike lehtësuese

Palët bien dakord që në masën më të plotë të lejuar sipas ligjeve të zbatueshme, Pala do të ketë të drejtë në mjete juridike urdhërues ose lehtësuese sipas kësaj Marrëveshjeje.

11.17 Nuk ka përgjegjësi për shqyrtim

Asnjë lloj shqyrtimi apo aprovimi nga Pala të ndonjë marrëveshjeje, dokumenti, instrumenti, skice, specifikimi apo projektimi të propozuar nga ndonjë Palë apo ndonjë inspektim të kryer nga një Palë sipas kësaj Marrëveshjeje nuk e liron Palën nga përgjegjësia që përndryshe do të kishte për neglizhencën e saj

në përgatitjen e asaj marrëveshjeje, dokumenti, instrumenti, skice, specifikimi apo projektimi, apo kryerjen e atyre punëve, apo dështimi në respektim të LiGJeve të zbatueshme të Kosovës, apo që të përmbushë obligimet e Palës në këtë Marrëveshje, e as që Pala mund të jetë përgjegjëse para Palës apo ndonjë personi tjetër për arsye të shqyrtimit apo provimit nga ai të marrëveshjes, dokumentit, instrumentit, skicës, specifikimit apo projektimit apo të inspektimit të tillë.

11.18 Palët homole

Kjo Marrëveshje mund të ekzekutohet në dy (2) apo më shumë ekzemplarë origjinalë, si dhe secila kopje mund të ekzekutohet nga secila Palë në parafime të ndara, ku secila kopje kur ekzekutohet dhe dorëzohet nga Palët konsiderohet origjinale, por të gjitha këto bashkërisht përbëjnë një dhe të vetmin instrument.

11.19 Sigurimet e mëtutjeshme

Secila Palë ekzekuton të gjitha dokumentet e arsyeshme e të domosdoshme për të vënë në zbatim qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

11.20 Pandashmëria

Nëse ndonjë kusht apo dispozitë e kësaj Marrëveshjeje shpallet nga një gjykatë apo ndonjë autoritet tjetër me kompetencë që të jetë e pavlefshme, e pavlerë, e paligjshme, e pazbatueshme, apo në kundërshtim me politikat publike, (i) dispozitat tjera të kësaj Marrëveshjeje mbeten plotësisht në fuqi dhe efekt, si dhe nuk ndikohen në asnjë mënyrë nga ai vendim, si dhe (2) Palët duhet të takohen shpejt dhe të negociojnë zëvendësimin e asaj dispozite apo pjese, e cila deri në masën më të madhe ligjërisht të lejueshme, do të zbatohet qëllimin fillestar të Palëve.

11.21 Pavlefshmëria e Pjesshme

Paligjshmëria, pavlefshmëria, apo pazbatueshmëria e cilësdo dispozitë në këtë Marrëveshje, të tërë apo pjesërisht, sipas ligjit të cilitdo juridiksion, nuk ndikon:

- (a) As ligjshmërinë, vlefshmërinë apo zbatueshmërinë sipas ligjit të ndonjë juridiksioni tjetër; e as
- (b) Ligjshmërinë e dispozitave apo pjesëve të tjera të saj.

NË DËSHMI TË KËSAJ, Palët ekzekutojnë dhe dorëzojnë këtë Marrëveshje në Prishtinë, Kosovë, në datën e shkruar si më lart.

Në emër të
Republika e Kosovës duke vepruar përmes
Zyrës së Kryeministrit dhe
Ministrit të Zhvillimit Ekonomik

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

ContourGlobal Terra 6 S.à r.l. në cilësinë e tij si
Sponsor HoldCo

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

ContourGlobal Terra 6 S.à r.l. në cilësinë e tij si
GenCo

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Schedule 1
Forma e financimit Letër kredie

Të gjitha letrat e kredisë do të:

1. emërojnë QK si përfituese të saj;
2. ketë afat prej jo më pak se një (1) vit;
3. lëshohet nga një bankë e kualifikuar (ose degë e saj) e vendosur në dhe me mundësi tërheqjeje në Bashkimin Evropian ose në një vend tjetër të miratuar nga QK;
4. ketë një shumë maksimale në dispozicion për tërheqje në total agregat të barabartë me shtatë milionë e pesëqind mijë Euro (7.500.000 Euro) minus shuma e Depozitit financiar që është siguruar për QK sipas nenit 5.1 (*Sigurimi i Financimit*), shuma e të cilës do të zbritet në përputhje me tërheqjet përkatëse;
5. cekë shprehimisht që as pala kontabël as emetuesi nuk mund ta përfundojnë atë para datës së skadimit pa pëlqimin me shkrim të GOK;
6. mund të tërhiqet me kërkesën e parë vetëm kundrejt dorëzimit të një kërkesë dhe njoftimi për emetuesin lidhur me realizimin e Ngjarjes së Tërheqjes të Sigurisë së Financimit ose Ngjarjes së Tërheqjes së Dështimit të Zëvendësimit;
7. përfshijë procedura të realizueshme dhe praktike të tërheqjes në këndvështrimin e arsyeshëm të QK; me kusht që të mos përmbajë ndonjë kusht për tërheqje përveç konfirmimit nga emetuesi se çdo certifikatë tërheqjeje që kërkohet të dorëzohet në lidhje me një tërheqje duket se përputhet me kërkesat e kësaj Letre Financiare të Kreditimit;
8. jetë e kënaqshme sa duhet në formë për QK; me kusht që një letër kredie në formën e letrës së kredisë të bashkangjitur si në Aneksin 1 i të kësaj Skemës 1 që përndryshe i plotëson kriteret e përcaktuara këtu, duhet të plotësojë kërkesat për formën e Sigurimit të Financimit;
9. sigurojë që përfituesi i tij mund të bëjë tërheqje të shumta mbi të; dhe
10. cekë shprehimisht se do t'i nënshtrohet Praktikave Ndërkombëtare Standby 1998 dhe, deri në atë masë që nuk janë në kundërshtim me Praktikën Ndërkombëtare të Standby 1998, Ligjet e Nju Jorkut.

Aneksi 1 i Skemës 1 Forma e financimit të letrës së kredisë

[Ballina e bankës emetuese]

LETRA E PAREVOKUESHME E KREDISË STANDBY

Numri: [●]
Shuma: [●]
Data e cekur e skadimit: [●]
Partia e Llogarisë: [●]

Republika e Kosovës

duke vepruar përmes **Ministrit të Zhvillimit Ekonomik**

[●]

[●], Kosovë

Tema: Letër Kredie Nr. [●]

I referohemi Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit, të datës [●] (të ndryshuar ose modifikuar ndryshe, “*Marrëveshja për Mbështetjen e Sponsorit*”) ndërmjet QK (“*Përfituesi*”), GenCo dhe Sponsor HoldCo. Kurdo që termat vijues paraqiten në këtë Dokument, ato do të kenë kuptimet e dhëna si më poshtë:

Ne e vendosim këtë Letër të Parevokueshme Kredie Nr. [●] (kjo “*Letër Kredie*”) për përfitim të Përfituesit në shumën e barabartë me gjithsej [●] ([●]) (“*Shuma e Tërheqjes*”). Fondet nën këtë Letër Kredie janë në dispozicion për ju pas pranimit të një certifikate në formën e Shtojcës A të bashkangjitur këtu, duke na njoftuar për ndodhjen e një Ngjarjes Financiare të Tërheqjes të Sigurimit ose Ngjarjes së Tërheqjes së Dështimit të Zëvendësimit (një “*Certifikatë Kërkesë*”), të plotësuar dhe nënshkruar nga zyrtari, punonjësi ose nënshkruesi juaj i autorizuar, nëse certifikata e tillë e kërkesës është paraqitur si më poshtë ose para datës së skadimit (siç përcaktohet më poshtë).

Ju do të paraqisni një Certifikatë Kërkesë të datës së paraqitjes për çdo tërheqje në kuadër të kësaj tek [emri dhe adresa e bankës lëshuese]. Nëse paraqitni Certifikatën e Kërkesës deri në orën 10:00 në kohë lokale në çdo ditë në të cilën ne jemi të hapur për punë (çdo ditë e tillë, një *Ditë Pune*), në përputhje të plotë me termat dhe kushtet e kësaj Letër Kredie, ne do ta nderojmë atë duke bërë pagesa në fonde të disponueshme, në përputhje me instruksionet tuaja të pagesave dhe pa ndonjë kufizim, kushte, kërkesë apo të drejtën e kundërshtimit nga ana jonë, pa njoftim për palën e llogarisë para pagesës së tillë dhe pavarësisht kushteve, kërkesave ose vërejtjeve nga pala e llogarisë ose nga ndonjë palë tjetër, pa pasur nevojë ta mbështesni më tej këtë kërkesë, deri në orën 16:00 në kohë lokale në Ditën e tillë të Punës, apo përndryshe do ta respektojmë Certifikatën tuaj të Kërkesës deri në orën 10:00 në kohën lokale pas Ditës së Punës.

Nëse ndonjë kërkesë për pagesë nuk është në përputhje me kushtet dhe termet e kësaj Letër Kredie, ne do t’ju japim njoftim të shpejtë të të njëjtës duke i cekur arsyet e kësaj dhe, me kërkesën tuaj, do t’i ruajmë dokumentet e paraqitura për ne për pesë (5) ditë pune apo të njëjtat do t’i kthejmë tek ju. Pas njoftimit se një kërkesë për pagesë nuk ishte në përputhje me këtë Letër Kredie, ju mund ta përmirësoni kërkesën mospërputhëse; me kusht që kërkesa e përmirësuar do të bëhet dhe paraqitet tek ne më datë apo para datës së skadimit (të përkufizuar më poshtë).

Letër Kredia do të skadojë në ora 17.00 në zyrën tonë, në momentin që është më herët, si në vijim: (I) data e cekur e skadimit; (ii) nderimi ynë i kërkesave të paraqitura këtu, në total, barabartë me Shumën e Tërheqjes; dhe (iii) dorëzimit nga ana juaj të letrës fillestare të kredisë për anulim. Ngjarja më e hershme

e datave më sipër referohet si “Data e skadimit”. Përveç nëse shprehimisht parashikohet ndryshe në këtë paragraf, kjo Letër Kredie nuk ndërpret datën paraprake të skadimit për çfarëdo arsyeje.

Mund të bëni tërheqje të shumëfishta dhe të pjesshme në kuadër të kësaj. Secila tërheqje do të zbresë shumën e disponueshme për tërheqje në kuadër të kësaj Letër Kredie.

Kjo Letër Kredie përcakton në tërësi sipërmarrjet tona dhe referencat brenda saj në çdo dokument, instrument apo marrëveshje, përveç Certifikatës së Kërkesës së referuar këtu, nuk ndryshon në asnjë mënyrë, modifikon, amplifikon apo kufizon sipërmarrjen tonë.

Të gjitha dokumentet e paraqitura tek ne në lidhje me kërkesat për pagese, si dhe të gjitha njoftimet dhe komunikimet e tjera me ne në kuptim të kësaj Letër Kredie do të bëhen me shkrim dhe do të adresohen dhe paraqiten tek ne në zyrat tona në [adresa e bankës së lëshimit] Vërejtje: [●], dhe do të bëj referencë në këtë Letër Kredie me numër. Ju personalisht do t’i dorëzoni këto dokumente, njoftime dhe komunikime të tjera për ne apo do t’i dërgoni ato te ne me faks tek [●], apo numri përkatës i specifikuar me kalimin e kohës tek ju.

Kjo Letër Kredie do t’i nënshtrohet Praktikave Ndërkombëtare Standby 1998 (“ISP98”) dhe, deri në atë masë që nuk janë në kundërshtim me ISP98, të qeverisur nga Ligjet e Nju Jorkut.

[BANKA EMETUESE]

Nga: _____
Emri:
Titulli:

**KJO SHTOJCË A PËRBËN PJESË INTEGRUESE TË
LETËR KREDISË NR. [●]
DATË [●]
SHTOJCA A
CERTIFIKATA E KËRKESËS
[DATA]**

[Adresa e Bankës emetuese]

Për: [●]

Re: Kërkesa për pagesë në kuadër të Letër Kredisë

Zonja dhe zoterinj:

I referohemi Letrës suaj të Kredisë Nr. [●] (“Letër Kredia”) Përveç nëse konteksti nuk kërkon ndryshe, termat me shkronja të mëdha që paraqiten në këtë Dokument do të kenë kuptimet e dhëna si në Letrën e Kredisë: Ne vërtetojmë që ka ndodhur një [Ngjarje e tërheqjes së sigurimit të financimit] dhe se përfituesi ka të drejtë të tërheqë shumën e përcaktuar më poshtë në përputhje me kushtet e Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit. Përfituesi kërkon pagesën e [shumës] në kuadër të Letrës së Kredisë, pagesa e tillë që duhet bërë për [futni udhëzimet e llogarisë] .

Në dëshmi të palëve, kjo Certifikatë e Kërkesës është ekzekutuar dhe dorëzuar nga Përfituesi më [●].

Republika e Kosovës
duke vepruar përmes **Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik**

Nga: _____
Emri:
Titulli:

Schedule 2
Formulari i garancisë së sponsorit përfundimtar
GARANCIA E SPONSORIT PËRFUNDIMTAR
NË LIDHJE ME PROJEKTIN KOSOVA E RE

GARANCIA E SPONSORIT PËRFUNDIMTAR (kjo “Garanci”) lidhet më _____ (“Data e ekzekutimit”) nga:

- (1) ContourGlobal plc, një kompani publike me përgjegjësi të kufizuar e korporatizuar në Angli dhe Uells, me zyra të regjistruara në 15 Berkeley Street, 6th Floor, London W1J 8DY, United Kingdom, (Sponsori Përfundimtar), në dobi të.
- (2) Republika e Kosovës (**QK**) duke vepruar përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Sponsori Përfundimtar dhe QK, në tekstin e mëtejme referohen individualisht si “Pala” dhe, bashkërisht, “Palët.”

PËRSHKRIMET (RECITALET)

- A. QK ka për qëllim të përfshijë sektorin privat në një projekt të infrastrukturës të energjisë elektrike të thëngjillit që përfshin zhvillimin, projektimin, ndërtimin, financimin, pronësinë, operimin dhe mirëmbajtjen e objektit të TCKR dhe rehabilitimin e Lokacionit (siç përcaktohet më poshtë) nga GenCO (“**Projekti Kosova e Re**”);
- B. GOK dhe ContourGlobal Terra 6 S.à rl dhe GenCo lidhin Marrëveshjen për Mbështetjen e Sponsorit të datës së saj (“**Marrëveshja për Mbështetjen e Sponsorit**”);
- C. Është term sipas nenit 10.1 (*Garancia e Sponsorit Përfundimtar*) e Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit që Sponsori Përfundimtar do të ekzekutojë dhe dorëzojë këtë Garanci.

PRANDAJ, duke pasur parasysh premtimet dhe pajtimet e ndërsjella të përfshira në këtë dokument, dhe me qëllim që të jenë ligjërisht të detyrueshme, Palët bien dakord si më poshtë:

Article 1
Garancia

1.1 Garancia

Sponsori Përfundimtar me anë të kësaj në mënyrë të përvokueshme dhe pa kushte i garanton QK për këtë afat siç parashikohet në nenin 1.2:

- (a) kryerjen e duhur dhe të përpiktë të të gjitha termave, kushteve dhe dakordimeve të Sponsor HoldCo në Marrëveshjen e Mbështetjes së Sponsorit dhe zotohet të sigurojë kryerjen e detyrimeve që rrjedhin prej saj; dhe
- (b) pagesën e plotë dhe të menjëhershme të çdo shume që Sponsor HoldCo dështon të paguajë kur detyrohet sipas Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit,

kolektivisht, “**Obligimi i Garantuar**”, me kusht që shumat në Kontest në kuadër të Marrëveshjes së Mbështetjes së Sponsorit do të konsiderohen të mos jenë të detyrueshme dhe për shkak të qëllimeve të kësaj Garancie deri pas zgjidhjes së çdo Kontesti që lind në lidhje me shumat e pagueshme në përputhje me procedurat e zgjidhjes së Konsteve të parashikuara në Marrëveshjen e Mbështetjes së Sponsorit duke përfshirë periudhën e pagesës pas zgjidhjes së Kontestit të parashikuar në nenin 11.1 (*Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*) të Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit.

1.2 Efektiviteti; Afati i garancisë

Kjo garanci:

- (a) fillon dhe hyn në fuqi pas (i) datës së ekzekutimit, dhe (ii) datës në të cilën hyn në fuqi Marrëveshja për Blerje të Energjisë në pajtim me nenin 2.1(b) (hyrja në fuqi; afati) i Marrëveshjes për Blerje të Energjisë (ku kjo datë e hyrjes në fuqi do të jetë “**Data e hyrjes në fuqi**”); dhe
- (b) mbetin në fuqi dhe efekt të plotë deri në momentin më të hershëm nga:
 - (i) skadimi ose përfundimi i Marrëveshjes së Zbatimit; dhe
 - (ii) koha që një Huadhënës (ose çdo Person në emër të Huadhënësve) ushtron të drejtat e tij kolaterale dhe Marrëveshja për Mbështetjen e Sponsorit është caktuar sipas nenit 11.14(a) të Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit.

1.3 Heqja dorë nga mbrojtja

As detyrimet e Sponsor HoldCo të përfshira këto as të drejtat, autorizimet dhe mjetet e dhëna tek Sponsor Përfundimtar për sa i përket Sponsor HoldCo me ligj apo ndryshe nuk do të lirohen, dëmtohen ose cedohen ndryshe nga ndodhja e të gjitha ngjarjeve, çështjeve, veprimeve, mosveprimeve, përfshirë si në vijim:

- (a) zgjatja e kohës për pagesën e çdo shume të detyruar ose të kohës për kryerjen e ndonjë dakordimi, kushteve ose marrëveshjeve të Sponsor HoldCo në kuadër të Marrëveshjes së Mbështetjes së Sponsorit;
- (b) çdo ndryshim në Marrëveshjen për Mbështetjen e Sponsorit; me kusht që përveç nëse është marrë pëlqimi paraprak me shkrim i Sponsorit Përfundimtar për ndryshimin e tillë, kjo garanci nuk zbatohet për çdo ndryshim në marrëveshjen e Mbështetjes së Sponsorit që materialisht rrit detyrimet e Sponsor HoldCo sipas Marrëveshjes së Mbështetjes së Sponsorit;
- (c) dështimi, mosveprimi ose vonesa nga Sponsor Përfundimtar ose Sponsor HoldCo për të zbatuar, konstatuar ose ushtruar ndonjë të drejtë, fuqi ose mjet juridik në kuadër ose në përputhje me kushtet e Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit ose këtë Garanci;
- (d) falimentimi, paaftësia e pagesës, apo dështimi tjetër ose paaftësia financiare e Sponsor HoldCo;
- (e) çdo dështim i Sponsorit Përfundimtar ose Sponsor HoldCo për të përmbushur kërkesat e ligjeve, rregulloreve ose urdhrave;
- (f) çdo caktim sipas nenit 11.14 (*Caktimi*) të Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit në përputhje me kushtet e saj;
- (g) shtimi, ose lirimi i pjesshëm ose i tërësishëm i çdo garantuesi ose pale tjetër, në mënyrë primare apo sekondare përgjegjëse për kryerjen e ndonjë prej dakordimeve, kushteve ose marrëveshjeve të përcaktuara në Marrëveshjen e Mbështetjes së Sponsorit, ose nga ndonjë shtyrje, heqje dorë, ndryshim ose çdo veprim tjetër që mund të lëshojë ose krijojë mbrojtje për garantuesin (përveç performancës në përputhje me kushtet e Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit); ose
- (h) çdo pavlefshmëri ose pazbatueshmëri e Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit ose ndonjë prej dispozitave, kushteve ose termave të tyre përkatëse në bazë të mungesës së autoritetit të Sponsor HoldCo për të lidhur marrëveshje të tillë ose mungesën e autoritetit të nënshkruesit për të detyruar Sponsor HoldCo.

1.4 Garancia e vazhdueshme

Asnjë kërkesë e bërë nga QK në kuadër të kësaj nuk do të paragjykojë ose kufizojë të drejtat e Qeverisë për të bërë kërkesa të mëtejshme ose të tjera sipas kushteve të kësaj Garancie.

1.5 Siguria shtesë

- (a) Kjo garanci duhet të jetë shtesë dhe jo zëvendësim ose shmangie e ndonjë sigurie tjetër që QK mund ta ketë në çdo kohë në lidhje me detyrimet e Sponsor HoldCo në kuadër të Marrëveshjes së Mbështetjes së Sponsorit.
- (b) QK mund ta zbatojë këtë garanci, pavarësisht se mund të mbajë ndonjë garanci, barrë, ose siguri për ose të Sponsor HoldCo në kuadër të Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit, ose të ketë në dispozicion të tij ndonjë mjet tjetër juridik ose ekuitet.

1.6 Kërkesa paraprake

- (a) Pavarësisht që kjo garanci është obligim i pakushtëzuar i Sponsorit Përfundimtar, QK nuk do të kërkojë pagesën ose performancën, siç mund të jetë rasti, për çdo Obligim të Garantuar, përveç dhe deri:
 - (i) QK do të ketë njoftuar Sponsorin Përfundimtar (me një kopje për Sponsor HoldCo) lidhur me mospagesën apo moskryerjen e Obligimit të Garantuar siç kërkohet me kushtet e Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit dhe nenin 1.8; dhe
 - (ii) çdo periudhë e përcaktuar në Marrëveshjen e Mbështetjes së Sponsorit gjatë së cilës Sponsor HoldCo mund të sanojë mospagesën apo moskryerja e tillë ka skaduar para se Sponsor HoldCo të ketë paguar ose prokuruar kryerjen e detyrimeve të tilla të garantuara.
- (b) Në varësi të nenit 1.6(a), Sponsorin Përfundimtar do të bëjë pagesën ose të sigurojë kryerje brenda tridhjetë (30) ditëve pas kërkesës për pagesë ose kryerje, sipas rastit, në përputhje me nenin 1.8 dhe siç parashikohet ndryshe në këtë marrëveshje.
- (c) Përveç siç parashikohet në nenin 1.6(a), QK nuk do të jetë i obliguar para se të ndërmarrë hapa për ta zbatuar këtë garanci, që të ushtrojë ndonjë mjet tjetër që mund të jetë në dispozicion në kuadër apo në lidhje me Marrëveshjen për Mbështetjen e Sponsorit, ose për të iniciuar ndonjë procedurë ose marrë aktgjykim kundër Sponsorit Përfundimtar mbi të.

1.7 Certifikimi

Çdo kërkesë për pagesë e bërë në përputhje me këtë Garanci duhet të shoqërohet me një certifikatë të nënshkruar nga një zyrtar i autorizuar i QK ku thuhet se:

“Republika e Kosovës (“**QK**”) që vepron përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik me anë të kësaj vërteton për ContourGlobal plc (“**Sponsorin Përfundimtar**”) që (A) QK e bën këtë kërkesë për Sponsorin Përfundimtar për pagesë nga Sponsorin Përfundimtar në vlerë prej € [●] në përputhje me nenin 1.1 të Garancisë të datës [●] [●] 20 [●], nga Sponsorin Përfundimtar në favor të QK; (B) (1) Marrëveshja për Mbështetjen e Sponsorit nuk është ndërprerë (përveçse në lidhje me ngjarjen ose rrethanat për të cilat është bërë kërkesa) në përputhje me kushtet e saj ose çështja për të cilën është bërë kërkesa ka mbijetuar këtë ndërprerje, dhe (2) shuma e specifikuar më sipër është e detyrueshme dhe e pagueshme nga Sponsor HoldCo sipas Marrëveshjes së Mbështetjes së Sponsorit; (C) kërkesa me shkrim për pagesë nga Sponsorin Përfundimtar është dorëzuar tek Sponsorin Përfundimtar më apo pas datës së pagesës ose ekzekutimit të detyrueshëm dhe njoftimi për mospagesë ose mospërmbushje është dorëzuar tek Sponsorin Përfundimtar jo më pak se shtatë (7) Ditë para datës së këtij dokumenti; dhe (D) shuma e tillë, në datën në fjalë, mbetet e papaguar ose një performancë e tillë, në datën e saj, nuk është plotësuar.”

1.8 Njoftimi dhe pagesa

- (a) Nëse QK nuk do t'i ketë pranuar të gjitha ose ndonjë pjesë të Obligimit të Garantuar datën e caktuar për të ose para kësaj date, do ta njoftojë Sponsorin Përfundimtar (me një kopje për Sponsor HoldCo) brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditëve të Punës pas kësaj. Njoftimi i tillë duhet të përcaktojë se ka kaluar afati i pagesës ose kryerjes së detyrimit të tillë të garantuar, që QK ka ushtruar të drejtat e tij në pajtim me Marrëveshjen për Mbështetjen e Sponsorit, shumën e detyrimit të garantuar që mbetet i papaguar ose i pakryer dhe se shuma e papaguar ose obligimi i pakryer nuk është kontestuar në pajtim me Marrëveshjen për Mbështetjen e Sponsorit ose çdo mosmarrëveshje është zgjidhur në favor të QK.
- (b) Përveç siç parashikohet në nenin 1.8, QK nuk do të jetë i obliguar para se të ndërmarrë hapa për ta zbatuar këtë garanci, që të ushtrojë ndonjë mjet tjetër që mund të jetë në dispozicion në kuadër apo në lidhje me Marrëveshjen për Mbështetjen e Sponsorit, ose të marrë aktgjykim kundër Sponsor HoldCo mbi të.
- (c) Me kusht që Sponsorin Përfundimtar të ketë pranuar njoftimin siç parashikohet në nenin 1.8(a), pagesa nga Sponsorin Përfundimtar e çdo Obligimi të Garantuar që duhet të paguhet nga Sponsorin Përfundimtar sipas kësaj Garancie ose kryerja e ndonjë Obligimi të Garantuar që do të kryhet nga Sponsorin Përfundimtar sipas kësaj Garancie, duhet të jetë në çdo rast brenda tridhjetë (30) ditëve pas njoftimit të dhënë sipas nenit 1.8(a).

1.9 Kërkesa për kompensim në proces

Asnjë veprim apo mosveprim i ligjshëm i çfarëdo lloji ose në çdo kohë nga ana e QK në asnjë mënyrë nuk do të ndikojë ose pengojë të drejtat e QK për të zbatuar ndonjë të drejtë, autorizim, ose përfitim sipas kësaj Garancie dhe asnjë kërkesë për kompensim, kërkesëpadi, kundërpadi, reduktim, ose zvogëlim i çdo detyrimi ose ndonjë mbrojtjeje që Sponsorin përfundimtar ka ose mund të ketë ndaj QK nuk do të jetë në dispozicion të Sponsorit përfundimtar ndaj QK në përcaktimet e tij për të vepruar sipas kësaj ose padie ose veprimi të sjellë nga QK për të zbatuar çdo të drejtë, ose për të përfituar sipas kësaj Garancie; me kusht që përkundër asj më sipër, Sponsorin Përfundimtar do të ketë përfitimin e të gjitha të drejtave të kompensimit, kërkesës, kundërpadisë, reduktimit ose zvogëlimit të ndonjë obligimi të padiskutueshëm të likuiduar të QK ndaj Sponsor HoldCo sipas Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit, ose që është e lidhur ndryshe me Projektin Kosova e Re.

1.10 Vartësia

Çdo e drejtë që Sponsorin Përfundimtar mund ta ketë në çdo kohë për t'u zhdëmtuar nga Sponsor HoldCo, në lidhje me shumatat e paguara nga Sponsorin Përfundimtar në përmbushjen e kësaj Garancie, do t'i nënshtrohen të drejtave të QK që të kthehet nga Sponsor HoldCo të gjitha shumatat e plota që mund të detyrohen në çdo kohë nga Sponsor HoldCo sipas Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit.

1.11 Arbitrazhi; jurisdiksioni

1.11.1 Arbitrazhi

Palët bien dakord në mënyrë të parevokueshme që çdo mosmarrëveshje ose ndryshim që lind në lidhje me këtë garanci, përfshirë çdo mosmarrëveshje ose ndryshim në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose zbatimin e kësaj garancie ose të ndonjë dispozite të kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë ekzistencën, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e marrëveshjeve të përfshira në këtë nen 1.11.1) ose nëse kjo Garanci ose ndonjë dispozitë e saj (duke përfshirë marrëveshjet e përmbajtura në nenin 1.11.1) janë të pavlefshme, të paligjshme ose të pazbatueshme do të zgjidhen në përputhje me dispozitat e nenit 11.1 (*Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*) të Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit, të cilat janë përfshirë këtu nëpërmjet referencës, *mutatis mutandis*.

1.11.2 Imuniteti Sovran; Juridiksioni

Sponsori Përfundimtar në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar:

- (a) jep pëlqimin e përgjithshëm për juridiksionin, në lidhje me veten dhe për të gjitha asetet dhe pronat e tij, si dhe pronën që e ka tash apo më vonë mund ta përvetësojë, e cilësdo gjykatë me kompetencë në Kosovë për cilindo mocion të parashtruar nga QK për të përmbuar vendimin e cilitdo arbitër që është emëruar sipas kësaj Garancie për të zgjidhur Kontestin ndërmjet Palëve (përfshirë bërjen, zbatimin apo ekzekutimin ndaj ose në lidhje me ndonjë nga pasuritë, pavarësisht përdorimit të saj ose të menduar);
- (b) Heq dorë nga çdo e drejtë e imunitetit që ai apo ndonjë prej aseteve të tij ka tash apo mund të ketë në të ardhmen në cilindo juridiksion në lidhje me ato procedura;
- (c) Heq dorë nga cilindo kundërshtim që ka tash apo mund të ketë më vonë për vendin e ndonjë mocioni apo procedure të iniciuar sipas pëlqimeve në këtë nen 1.11.2, si dhe specifikisht heq dorë nga kundërshtimi që ai mocion apo procedurë është iniciuar në forum të papëlqyeshëm si dhe pajtohet të mos kërkojë apo parashtojë mocion për këtë; si dhe
- (d) Pajtohet që dorëzimi i shkresave të rastit në atë mocion apo procedurë mund të bëhet në çfarëdo mënyre që lejohet me ligjin që zbatohet për gjykatën e lartpërmendur.

1.11.3 Tarifat dhe Shpenzimet

- (a) Në varësi të nenit 1.11.3(b), nëse një mosmarrëveshje përcaktohet nga një tribunal i caktuar për të zgjidhur mosmarrëveshjet ndërmjet Palëve, Pala mbizotëruese (siç përcaktohet nga gjykata e tillë) ka të drejtë të pranojë, dhe Pala jo-mbizotëruese do të paguajë, përveç të gjitha mjeteve të tjera juridike për të cilat Pala mund të ketë të drejtë, tarifat dhe shpenzimet (duke përfshirë tarifat ligjore) të pësuara në mënyrë të arsyeshme nga Pala Kontestuese në Mosmarrëveshje (siç përcaktohet nga gjykata e tillë).
- (b) Pavarësisht nenit 1.11.3(a), QK do të ketë të drejtën të pranojë, dhe Sponsori Përfundimtar do të paguajë tarifat dhe shpenzimet (përfshirë tarifat ligjore) të pësuara nga ana e Qeverisë së Kosovës për të zbatuar çdo vendim të tribunalit të caktuar për të zgjidhur Mosmarrëveshjet ndërmjet Palëve.

Article 2

Nuk ka heqje dorë; Mjetet juridike kumulative

2.1 Nuk ka Heqje Dorë

Asnjë dështim apo vonesë nga QK për të ushtruar çdo të drejtë apo mjet sipas kësaj Garancie nuk përbën heqje dore nga ajo e drejtë apo korrigjim. Asnjë ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i ndonjë të drejte ose mjeti nuk përjashton ndonjë ushtrim tjetër ose të mëtejshëm të tij, ose ushtrimin e ndonjë të drejte ose mjeti tjetër. Asnjë heqje dore nga QK nuk do të jetë efektive përveç nëse është me shkrim.

2.2 Mjetet kumulative

Të drejtat dhe mjetet e QK të përcaktuara me këtë Garanci janë kumulative dhe jo ekskluzive të të drejtave apo mjeteve të përcaktuara me ligj.

Article 3

Caktimi

3.1 Caktimi

- (a) Kjo Garanci nuk mund të caktohet nga QK tek asnjë palë tjetër pa pëlqimin paraprak me shkrim të Sponsorit Përfundimtar.

- (b) Kjo Garanci nuk mund të caktohet nga Sponsorin Përfundimtar pa pëlqimin paraprak me shkrim të QK.
- (c) Kjo Garanci obligon dhe vlen për dobi të Palëve dhe çdo pasardhës apo të autorizuar që përfiton një interes sipas kësaj Marrëveshjeje në pajtim me nenin 3.1(a) dhe nenin 3.1(b).
- (d) Çdo transferim në kundërshtim me këtë nen 3.1 do të jetë nul dhe i pavlefshëm.

Article 4
Të ndryshme

4.1 Njoftimet

- (a) Të gjitha njoftimet dhe komunikimet tjera të kërkuara apo lejuara për t'u dhënë nga një Palë duhet të bëhen me shkrim si dhe të dorëzohen ose personalisht ose me postë të shpejtë ose të dërgohen me faks apo email në adresën apo numrin e Palës tjetër të specifikuar si më poshtë:

- (i) Nëse për ContourGlobal plc:

ContourGlobal plc,
15 Berkeley Street, 6th Floor, London W1J 8DY, United Kingdom]
Attention: The board of directors
Tel: +44 7825 028835
Fax: +1 646 386 9915
E-mail: CGK_CEO@contourglobal.com and
CGK_GC@contourglobal.com

- (ii) Nëse për QK:

Qeveria e Kosovës
Rr. Nene Tereza Nr. 36
Pristina, Kosovo
Për vëmendjen e: Blerand Stavileci
Tel: [_____]
Faks: [_____]
E-mail: [_____]

një kopje për (që nuk përbën njoftim):

Hunton & Williams LLP
Riverfront Plaza, East Tower
951 East Byrd Street
Richmond, Virginia 23219-4047
Attention: John J. Beardsworth, Jr.
Fax: +1-804-788-8218
E-mail: jbeardsworth@hunton.com

Me kusht, megjithatë, që Pala mund të ndryshojë adresën ku duhen dërguar njoftimet, duke dhënë njoftim paraprak me shkrim së paku tridhjetë (30) Ditë përpara për Palën tjetër në pajtim me këtë nen 4.1(a).

- (b) Asnjë njoftim e as komunikim nuk është efektiv deri sa të pranohet apo të konsiderohet i pranuar. Njoftimet apo komunikimet tjera konsiderohen të jenë pranuar nga Pala pranuese:
 - (i) Kur dorëzohen, nëse dorëzohen personalisht;
 - (ii) Tri (3) Ditë Pune pas dërgimit, nëse dërgohen me postë të shpejtë ndërkombëtare;

- (iii) Pas dërgimit, nëse dërgohen me faks, pas një konfirmimi të raportit të transmetimit të pandërprerë, si dhe me kusht që kopja në letër të dorëzohet jo më vonë se Dita vijuese e Punës tek pranuesi me postë të shpejtë ndërkombëtare ose dorëzim personal; ose
 - (iv) Pas dërgimit, nëse dërgohet me e-mail, me kusht që kopja në letër të dorëzohet jo më vonë se Dita vijuese e Punës tek pranuesi me postë të shpejtë ndërkombëtare ose dorëzim personal; me kusht, megjithatë, që Palët mundën, kohë pas kohe, të pajtohen bashkë me shkrim që nuk nevojiten kërkesat për dorëzim të kopjes në letër, duke marrë parasysh komunikimet operationale të përditshme apo në rutinë të ngjashme.
- (c) Pala që dorëzon njoftimin apo ndonjë komunikim tjetër në pajtim me nenin 4.1(a) duhet që të bëjë përpjekje të arsyeshme komerciale për t'i siguruar Palës pranuese përkthim arsyeshëm të saktë në gjuhën shqipe brenda pesë (5) Ditësh Pune pas dërgimit të atij njoftimi apo komunikimi tjetër në gjuhën angleze; me kusht, megjithatë, që Pala nuk do të jetë e detyruar të ofrojë përkthimin e skicave teknike apo dokumenteve inxhinierike. Në rast të mospërputhjeve ndërmjet origjinalit në anglisht dhe përkthimit në shqip të njoftimit apo komunikimeve të tjera, versioni anglisht do të mbizotërojë mbi versionin shqip. Për të shmangur dyshimet, dështimi në dorëzim të përkthimit të njoftimit apo komunikimeve tjera në pajtim me këtë nen 4.1(c) nuk e ndikon efektshmërinë e atij njoftimi apo komunikimeve tjera sipas përcaktimit të nenit 4.1(b).
- (d) Në rast se njoftimi i dorëzuar nga GenCo apo Sponsor HoldCo tek QK sipas kësaj Marrëveshjeje obligon QK ose të japë përgjigje (përfshirë aprovimet apo mos-kundërshtimet) brenda një periudhe të caktuar kohore apo të konsiderohet të ketë aprovuar apo të mos ketë kundërshtuar marrjen e veprimeve nga GenCo apo Sponsor HoldCo, GenCo do të përfshijë në atë njoftim edhe përshkrimin e periudhës së përgjigjes si dhe pasojat e dështimit të QK në përgjigje (përfshirë aprovimin apo mos-kundërshtimin e konsideruar si të tillë).

4.2 Ligji Qeverisës

Kjo garanci do të qeveriset dhe interpretohet në përputhje me ligjet e shtetit të Nju Jorkut, pa marrë parasysh dispozitat e konfliktit të ligjit që do të kërkonin zbatimin e ligjeve të ndonjë juridiksioni tjetër.

4.3 Pandashmëria

Nëse ndonjë kusht apo dispozitë e kësaj Marrëveshjeje shpallet nga një gjykatë apo ndonjë autoritet tjetër me kompetencë që të jetë e pavlefshme, e pavlerë, e paligjshme, e pazbatueshme, apo në kundërshtim me politikat publike, (i) dispozitat tjera të kësaj Marrëveshjeje mbeten plotësisht në fuqi dhe efekt, si dhe nuk ndikohen në asnjë mënyrë nga ai vendim, si dhe (2) Palët duhet të takohen shpejt dhe të negociojnë zëvendësimin e asaj dispozite apo pjese, e cila deri në masën më të madhe ligjërish të lejueshme, do të zbatohet qëllimin fillestar të Palëve.

4.4 Shprehjet me germa të mëdha

Shprehjet me germa të mëdha të përdorura por jo të përkufizuara në këtë Garanci do të kenë kuptimet e dhëna në Marrëveshjen e Mbështetjes së Sponsorit, që do të përfshijnë interpretimet e paraqitura në nenin 1.2 (*Interpretimi*) i Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit.

NË DËSHMI TË PALËVE, kjo Garanci është ekzekutuar dhe realizuar në emër të Sponsorit Përfundimtar në Prishtinë, Kosovë, në datën e shkruar si më lart.

ContourGlobal plc

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Dëshmitari: _____

Emri: _____

[Notari]